AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL**

**"INFERMIERI" me profile:**

**Infermieri Kirurgjikale,**
**Infermieri në Kujdesin Shëndetësor Parësor,**
**Nutricion dhe Dietologji.**

**UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Asc. Vjollca Durro**

**Dr. Nevila Heta**

**Mars /2020**



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

**PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT**

Universiteti Europian i Tiranës (UET)është institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, si Shkolla e lartë universitare jo publike " Universiteti Europian i Tiranës" si dhe programe të studimit të ciklit të pare. Në vitin 2011 me VKM Nr. 657 datë 25.09.2011. Ky institucion është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009. Institucioni është riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12 datë 7.04.2017 "Për akreditimin periodik të Universitetit Europian të Tiranës" me vlefshmeri akreditimi deri në vitin 2022.
UET përbëhet nga 5 njësi kryesore, Fakulteti i Inxhinierise, Informatikes dhe Arkitektures, Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marredhënieve Ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale dhe Fakulteti i Ekonomise, Biznesit dhe Zhvillimit

Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike është hapur me Urdhërin Nr. 530, date 04.09.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për hapjen e njësisë kryesore "Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike" në Universitetin Europian të Tiranës me tre programe studimi Bachelor në Infermieri, Fizioterapi dhe Imazheri.
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përbëhët nga Departamenti i infermierisë dhe fizioterapisë departamenti i imazherisë dhe qëndra e kërkimeve shkencore në Shëndetin Publik.
Programi i studimit Master Profesional në Infermieri me profile Infermieri Kirurgjikale, Infermieri në Kujdesin Shëndetësor Parësor dhe Nutricion dhe Dietologji është hapur me UMASH Nr. 336 datë 11.10.2018 me formë studimi me kohë të plotë. Programi ofrohet me 60 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje 1 vite akademik. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

**PROCESI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Raporti i vlerësimit të jashtëm përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të dytë për Masterin Profesional, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësim e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive.

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit, Mësimdhënia, Mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat, Burimet, Studentët dhe mbështetja e tyre dhe Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen,
- Standardet përmbushen pjesërisht,
- Standardet përmbushen kryesisht
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura, janë shqyrtuar një sërë dokumentesh dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks.**[ankesi lista e evidencave]**

Procesi i vlerësimit është administruar nga Koordinatori teknik nga ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof.As. Vjollca Durro dhe Dr. Nevila Heta Alliu, të cilat u asistuan gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm nga znj. Xhiliola Bixheku, koordinatore e teknike, përfaqësuese e ASCAL.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

Vlerësimi i brendshëm ku institucioni ka dorëzuar Raportin e vlerësimit të brendshëm së bashku me dokumentacionin mbështetës (DVB).

Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj fazë janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimet dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

Vizita në UET e zhvilluar në datat 21 dhe 22 Nëntor 2019. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.

Raporti i vlelësuesve të jashtëm bazohet në dokumentacionin e dorëzuar nga UET, Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit të cilat kanë ndihmuar në arritjen e konkluzioneve mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi.

Më datë 28.02.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 9/21 datë 28/02/2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 04.03.2020, përmes sistemit AMS, dërgohet shkresa zyrtare e Institucionit, me Nr. 06/19 Prot., datë 04.03.2020, me lëndë "*Përgjigjet për draftete vlerësimit të jashtëm për 3 programe studimi"*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportit, shprehet si vijon:

**Lidhur me standartin 1.4** GVJ nuk mer në konsideratë komentin e UET. Me kod pune individët nuk mund të punojnë me kohë të plote në dy institucione njëkohësisht. Në bazë të kodit të punës individit i njihen 40 orë në javë dhe me orët jashtë orarit deri në 50 orë në javë.
Gjithashtu UET nuk ka laboratorë për realizimin e praktikave mësimore në institucion.

**Për komentin e dytë standarti II.1:** GVJ I qëndron vlerësimit të pasqyruar në raport lidhur me ngarkesat mësimore të petagogëve dhe pasyrimin e tyre në orë dhe ETC sipas legjislacionit në fuqi. Orët e prakrikës profesionale janë të përfshira në ngarkesëen mësimore të programit mësimor të studimit, rrjedhimisht duhen të pasqyrohen dhe në ngarkesën mësimore të stafit akademik.

**Për komentin e trete: standarti II.5.** Pas rillogartitjes së ngarkesës mësimore të petagogëve në këtë program studimi sipas profileve GVJ shprehet se konstatimet e pasqyruara në RVJ qëndrojnë pasi sic është theksuar dhe në raport ka mospërputhje të ngarkesës mësimore të paraqitur në programin mësiomor me atë të pasqyruar në ngarkesën e stafit akademik të përfshirë në program.

**Për komentin e katërt standarti II.6:** Pas rishikimit te dokumentacionit të IAL, GVJ e mer në konsideratë komentin e UET dhe pasqyroi në raport ndryshimin**.**

**Për komentin e pestë standarti III 3.2:** Nuk meret në konsideratë komenti i UET pasi në dosjen elektronike nuk gjendet të gjitja CV e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi si dhe e departamentit përkatës.

**Për komentin e gjashtë standarti III.3:** Konstatimet e GVJ lidhur me këtë standart qëndrojne sepse në institucion nuk ka laboratorë mësimor për zhvillimin e praktikës mësimore (praktika profesionale zhvillohet në institucionet shëndetësore sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit). Në bibliotekën e institucionit apo departament nuk kishte leksione të shtypura në formë broshurë në gjuhën shqipe në dispozicion të studentëve të këtij programiu studimi.

**Për komentin e shtatë standarti III.8:** GVJ mer në konsideratë marrëveshjet në momentin e akreditimin. Konstatimet e GVJ qëndrojnë sepse me institucionet ku student e vitit të parë kanë kryer praktikën profesionale nuk kanë marrëveshje të shkruar me UET.

**Për komentin 8 standarti IV.**

GVJ i qëndron vlerësimit, në sistem nuk janë të gjitha CV e përsonelit akademik të departamentit përgjegjes, i cili mund të ndryshojë nga personeli akademik i angazhuar. GVJ do preferonte CV të përditësuar të cdo anëtari të personelit akademik për një vlerësim sa më real të situatë së punësimit ashtu dhe përgatitjes profesionale.
GVJ nuk ka deklarur se stafi akademik ka ndryshuar gjatë vitit akademik, por nga viti 2018-2019 në vitin 2019-2020, GVJ e konsideron pikë të dobët, ndryshime pothuesje të plotë të stafit nga njëri vit akademik në tjetrin sepse këto ndryshime ndikojnë në mënyrë të drejpëtdrejt në cilesinë e programit.
GVJ i qëndron komentit në lidhje më papërshtatshmërinë e stafit akademik të angazhuar në program me stafin akademik pjesë e personelit. Ky vlërësim është bërë pasi GVJ ka pritur dhe dokumentacionin shtesë. GVJ bën vlerësim për situatën që gjen në momentin e vizitës dhe dokumentacionit shtesë. Gjithashtu GVJ sqaron se nuk ka deklaruar në asnjë moment që në mësidhënie duhet të angazhohet vetëm përsoneli njësisë bazë. GVJ Instucioni duhet të ketë parasysh


Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: info@ascal.al
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

që ekspertet e GVJ kanë ekspërience mbi 20 vjecare në Institucione të arsimit të lartë dhe ky sqarim koment është i pavend.

**Përgjigje për komentin 9, standarti IV.3.** GVJ I qëndron vlerësim të bërë, edhe njëhëre vlerësimi bëhet në momentin e vizitës duke vlerësësuar tërë vitet e ofrimit të programit. GVJ nuk mund të vërtëtojë në këtë moment dryshimet infrastrukturore. Aq më tëpër GVB duhet ti qëndrojë deklarimit se: “Duhet të mbani parasysh që vlërësohet viti ti pare programit”

GVJ i qëndron vlerësimit që studentet e kanë kryer praktikën lëndore në institucione shëndetsore më të cilat Instutucioni nuk ka marrvëshje. Formalizimi i marrëveshjeve ka rëndësi shumë të madhe në këtë process për të siguruar një cilësisea më të lartë të një procesi shumë të rëndësishëm sic është praktika profesionale. Një marrëveshje e paformalizuar është e pabesueshme dhe krijonmundësia buzimi nga te dypalët.

**Përgjigje për komentin 10 standarti IV.4.** GVJ i qëndron krejtësisht vlerësimit në lidhje me literaturën e munguar dhe minimale në dispacion të studenteve.

**Përgjigje për komentin11 standarti IV.6.** GVJ I qëndron vleresimit në lidhje më pamundësinë për të dalë në një konkluzion për qëndrushmerinë financiare të instucionit dhe programit si pasoje e mungesës së infromacionit.

**Përgjigje për komentin 12 standarti IV.5** GVJ i qëndron vlerësimit, të dhënat në lidhje me vlerësimin e programit të studimit mungojnë në web.



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL "MASTER PROFESIONAL NË MENAXHIM SHËNDETËSOR"**

## I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.<br><br>**Kriteri 3** Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.<br><br>**Kriteri 4** Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) është institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, dhe akredituar për herë të fundit me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12 datë 7.04.2017 "Për akreditimin periodik të IAL Universiteti Europian i Tiranës për një afat 5 vjecar deri në vitin 2022. Programet që ofron nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit **[takimi me dekanin].** Programet e studimit të ofruara nga UET synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive dhe janë në përputhje me me misionin dhe objektivat e UET **[statusi dhe rregullorja e UET].** UET e ka fokusuar veprimtarinë e vet në disa drejtime si shkenca ekonomike, juridike, politike, marredhënie ndërkombëtare, arteve liberale, shkencave humane dhe në këtë kuadër në këto drejtime studimi janë edhe programet studimit.<br>Gjatë takimit me drejtuesit e FSHMT dhe programeve, programet e studimit të ofruara nga UET bazohen në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat e tregut të punës për infermier në përgjithësi dhe ata të specilizuar në profile të vecanta, takimet me petagogë të Universitetit të Mjekësisë, drejtues të urdhrave profesionistë në mjekësi, drejtues të institucioneve shëndetësore, panairin e punës ku institucione të ndryshme shëndetësore, firmat farmaceutike, spitalet apo OJF-të paraqesin mundësitë e tyre për të punësuar studentë të programeve master në infermieri. Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, ***GVJ nuk konstaoi sa janë nevojat reale për infermier të specilizuar në profilet që ofron ky program studimi, në vend apo rajonin e Tiranës në të cilat është bazuar apo orientuar UET për hapjen dhe zhvillimin e këtij program studimi*** **[studimi per tregun e punës]**<br>Referuar strategjisë së zhvillimi të UET dhe strategjisë së programit të studimit **[strategjia UET & programit të studimit],** programi i studimit është në të njëjtin linjë me zhvillimet social-ekonomike të vendit, shërbimit shëndetësor dhe politikave lokale apo rajonale. (Standardi I.1) |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** |
|---|



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1**. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.<br><br>**Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.<br><br>**Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.<br><br>**Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. | Institucioni ka hartuar planin strategjik të zhvillimit të institucionit për vitet 2015-2020 dhe strategjine e zhvillimit të programit të studimit MP në infermieri, në të cilën janë përcaktuar qartë drejtimet strategjike të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat të janë në përputhje me fushën e veprimtarisë të UET. **(Standardi I.2)**<br>Statuti i UET është miratuar me Urdhër Nr.90, datë 28.02.2018, të ministrit të Arsimit dhe Sportit. Institucioni ka dhe Rregulloren e përgjithshme të miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik. Gjithashtu EUT ka hartuar edhe rregulloret e njësive dhe strukturave të tjera **[rregullorja e njësisë bazë, programit të studimit, njsbc, sekretarisë, burimeve njerëzore, etj].** *GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton se këto akte rregullatore nuk janë sipas formatit zyrtarë (kokë, datë miratimi, nr protokolli, nënshkrimin e miratuesit etj). Gjithashtu disa regullore si: regullorja e burimeve njerëzore, dokumenti i praktikës profesionale, regullorja e sekteretarisë, regullorja për diplomat e studimit, për funksionimin e zyrës së këshillimit të karierës etj janë fragmente të shkëputura nga regullorja e përgjithshme e UET.* Lidhur me këto konstatime ***GVJ rekomandon këto rregullore të shkryhen sipas formatit zyrtarë dhe të përshtaten për programin përkatës*** **[Standardi I.2].** Bazuar në Statusin e UET-së, rregulloret janë në përputhje me fushën e veprimtarisë të UET-së dhe Strategjisë së Kërkimit Shkencor në UET **[takimi drejtuesit].**<br>Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit **[Statusi UET-së, Rregullorja UET-së, Strategjia e Kërkimit Shkencor së UET]**<br><br>Programi i studimit Master Profesional në "Infermieri" i profilizuar është hartuar dhe ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së UET, me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Standardi I.3<br>Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit "Master profesional" kanë | Programi i studimit paraqet në mënyrë përmbledhëse objektivat e tij **[strategjia, rregullorja e programit, kurikula].** Bazuar në këto objektiva, |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | programi i ciklit të dytë MP në infermieri i profilizuar në Infermieri Kirurgjikale, Infermieri në Kujdesin Shëndetësor Parësor, Nutricion dhe Dietologji synon të përgatisë profesionistë të infermieristikës të profilizuar në fushën përkatëse, të aftë profesionalisht për të punuar në sektorin publik dhe atë jo publik të shëndetësisë, ti aftësojë për kërkim të avancuar të pavarur shkencorë, për zhvillim karriere, si dhe të krijoj bazën për vazhdimin e studimeve të doktoratës.<br>Gjatë vizitës në institucion, GVJ identifikoi se institucioni akademik dhe drejtuesit, marrin informacione për nevojat e tregut të punës në mënyra të ndryshme si nëpërmjet studimit të tregut të punës, panairit të punës, takimeve të zhvilluara më petagogë, drejtuesit e urdherit të infermierit apo drejtues të institucioneve shëndëtësore (që përbëjnë bordin e tregut të punës në rang fakulteti), por si është theksuar edhe më lart nuk kanë të dhëna konkrete për nevojat reale të vëndit apo rajonit të Tiranës për infermierë në këto profile.<br><br>Në organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave të tregut të punës institucioni konsultohet me Bordin e Tregut të Punës në nivel Fakulteti **[takimi me drejtuesit dhe stafin akademik].**<br><br>Fakulteti i shkencave mjekësore ka organizuar takime me Bordin e Tregut të Punës, Ditën e hapur e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, duke i krijuar mundësi studentëve të kontaktojnë me biznese apo kompani që operojnë në fushën e shëndetësisë dhe të informohen lidhur me nevojat dhe mundësitë e tyre për staf infermieror si dhe mundësitë e punësimit të tyre në këto struktura. FSHMT nuk ka ende të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar pasi është viti i parë i Masterit Profesional në këtë profil.<br><br>Programi i studimit është organizuar në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*" në lëndë dhe module të cilat vlerësohen me kredite ECTS. Programi MP në infermieri më tre profile është me kohë të plotë studimi me zgjatje një vit akademik, të organizuar në dy semester dhe ngarkesë vjetore 60 kredite. Për hartimin e programeve UET ka marrë për bazë progamet e ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare.**[ takimi me stafin drejtues, strategjia e UET, kurikula e programit],** por GVJ nuk ka në dispozicion dokumente që vertetojnë atë. Gjithashtu programi ka një përputhje të pjeshme me MP në infermieristikë në insitucione të tjera të arsimit të lartë brënda vëndit, cka ndikon në mobilitetin e studentëve midis këtyre IAL.<br><br>Në kurikulën e programit të bie në sy numri i njëjtë i krediteve për të gjitha lëndët. ***Në të tre profilet vihet re se nuk ka lidhje midis lëndëve karakterizuese dhe atyre integruese***. psh në profilin infermieri kirurgjikale, mjekësia laboratorike (që nuk lidhet direkt me profilin) ka numër të njëjtë kreditesh (6 ECTS) me lëndët të tjera që lidhen dikrekt me profesionin. Në |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | |
| **Kriteri 4.** Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit hartohen në përputhje me | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | profilin dietologji dhe nutricion lënda farmakologji klinike me 6 etc , mund te jetë me më pak ECTS dhe mund të shtohet një lëndë që lidhen më shumë me këtë profil.<br>Bazuar në këtë informacion ***GVJ rekomandon rishikim e kurikulës dhe rishpërndarje të ECTS-ve në lëndët karakterizuese që nuk lidhen direkt me profilin. Psh në MP në infermieri  reduktimi i ECTS në mjekësi laboratorike  dhe futja e lëndëve që lidhen me këtë profil si njohuri mbi infeksionet nozokomiale për profilin infermieri kirurgjikale***. |
| **Kriteri 6**. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Niveli i dijeve të ofruara në programet e lëndëve është i përshtatshëm për nivelin e ciklit të dytë të studimeve. Masteri Profesionale në Infermieri i profilizuar, ofron njohuritë e nevojshme teorike për aftësimin dhe zhvillimin e kompetencës profesionale të studentëve në fushën e infermieristikës në profilin përkates.<br><br>Një nga komponentët më të rëndësishëm të programit është praktika profesionale. Ndërthuarja e njohurive teorike me kryerjen e praktikës profesionale i mundëson studentëve formimin profesional për përshtatjen e tyre në tregun e punës. Praktika profesionale ju mundëson studentëve njohjen nga afër me detyrat që do të ketë infermieri i cili do të punësohet në pozicione pune të ngjashme.<br>Bazuar në objektivat që ka programi dhe në planin mësimor, nuk u evidentuan elementë të mësimdhënies në gjuhë të huaj apo module të veçanta të programit. Në takimet në IAL dhe RVB theksohet se UET ka një sërë marveshje me institucionet arsimore kombëtare dhe ndërkombëtare, por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion( faqja  ascal-it) *GVJ konstaton se nuk ka dokumente të shkruar për bashkëpunim më këto institucione.* |
| **Kriteri 7.** Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin. | |
| **Kriteri 8.** Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.4**<br>**Programet e ciklit të dytë "Master profesional" janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike | Institucioni UET ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit  të parë dhe të dytë (licensuar me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12 datë 7.04.2017 "Për akreditimin periodik të IAL Universiteti Europian i Tiranës me kohëzgjatje normale 5 vite akademie). Çka tregon se tashme institucioni ka krijuar profilin e vetë në mënyrën e organizimit, |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon **[vizita e ambienteve]** |
| **Kriteri 2**. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Krahasuar me numrin aktual të studentëve të regjistruar dhe që ndjekin studimet, institucioni ka kapacitetet dhe burimet financiare që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit, ***por mungon logjistika laboratorike e nevojshme për zhvillimie MP në infermieri*** **[vizita në ambiente].**<br>GVJ e konsideron praktikë të mirë infrastrukturën mësimore që disponon institucioni, dhe përpjekjet për ngritjen e laboratorit me pajisjet e duhura laboratoriketë cilat ndihmojnë në praktikimin e njohurive të marra nga studentët.<br>Programi MP Infermieri me profile në infermieri kirurgjikale, nutricion dhe dietologji, shëndet publik përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të FSHMT. [***Refernca 9 në fund të fq 8 të RVB nuk përputhet me dokumentin që i referohet].***<br><br>GVJ evidentoi problematika përsa i përket kapaciteteve akademike. Referuar të dhënave mbi stafin akdemik për vitin akademik 2018-2019 deparatmenti përbëhët nga 11 petagogë, shtatë prej të cilëve janë PAE, ***por GVJ konstaton se një pjesë e këtyre petagogëve janë të dypunësor me kohë të plotë në dy institucione njëkohësisht*** **[lista e stafit], [cv e stafit], [ngarkesa e stafit akademik].** |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Për vitin akademik 2019-2020 deparatmenti përbëhët nga 15 petagogë, 7(46,6%) prej të cilëve janë PAE dhe 8(53.33%) petagogë me kontratë.<br><br>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore i cili për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020 ofron 7 programe të ciklit të parë dhe të dytë:<br>– Bachelor në “Infermieri”.<br>– Bachelor në “Fizioterapi”.<br>– Bachelor në “imazheri”.<br>– Program i integruar “Master i shkencave” në “Infermieri”<br>– Program i integruar “Master i shkencave” në “fizioterapi”.<br>– Program i integruar “Master i shkencave” në “imazheri dhe radioterapi”.<br>– “Master profesional” në “Infermieri” në tre profile .<br><br>Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore **[dokumenti programet FSHM]**<br><br>Programi i studimit MP në infermieri ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit.<br>Niveli i njohurive që ofron programi përkon me atë të nivelit 7 të KSHK / EQF **[programi]** |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master | |


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | UET është një institucion jo publik që ka një numër të vogël studentësh në këtë program studimi, por jo në numër programesh që ofron **[lista e programeve].** Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon.<br>Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit **[takimi me dekanin, shefin e departamentit],** bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. Disa anëtarë të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose në komisione të ngritura për tematika të ndryshme.<br><br>Për realizmin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional institucioni i UET ka marrëdhënie me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, me institucionet shëndetësore publike e private si dhe shkëmbime eksperience me IAL jashtë vendit, **[RVB, takimi me stafin drejtues, marveshjet],** ***por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion institucioni ka marërveshje të shkruara me dy institucione shëndetësore si QSUT Nënë Tereza dhe Spitali Amerikan në të cilat*** studentët zhvillojnë praktikën profesionale.<br>Egzistenca e një numri të vogël studentësh, jep mundësi të realizimit të praktikes profesionale në institucione shëndetësorë publike apo privatë pranë qëndrave të banimit apo vëndeve të punës.<br>Institucioni ka një databaza lidhur me institucionet ku studentët kryejnë praktikën profesionale ***por nuk ka marrëveshje të shkruar me këto*** institucione për zhvillimin e praktikës profesionale [**dokumenti nr 60 Institucionet bashkëpunuese].** Praktika mbikqyret nga një kordinator i caktuar, kordinatori i programit i cili koordinon me institucionin ku studenti realizon praktikën profesionale. Vlerësimi i praktikës kryhet sipas regullores përkatëse të UET **[dokumenti praktikës, takimi me stafin akademik].** Nga |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | |
| Kriteri 3. Për realizmin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

<table>
<tr><td>bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</td><td colspan="4" rowspan="3">shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në disoizicion GVJ konstatoi se programi ka formularin e aplikimi për praktikën profesionale, formularin e vlerësimit të praktikës profesionale nga petagogu mbikqyrës dhe institucioni ku student ka kryer praktikën, formular vetëvlerësimi nga student. Formulari i aplikimi për praktikën profesionale, plotësohet nga studenti dhe i dorëzohet koordinatores së departamentit. Në këtë dokument studenti propozon institucionin ku ai preferon të kryejë praktikën profesionale (i cili përzgjidhet nga lista që UET-i ka vënë në dispozicion, ose propozohet nga studentit) dhe paraqet shkurtimisht objektivat që kërkon të realizojë gjatë praktikës.,<br><br>UET ka një traditë të mirë në organizmin e programeve te trajnimit profesional të studentëve të diplomuar për të përmirësuar aftësitë e tyre profesionale. UET përpiqet që nëpërmjet, aktiviteteve të ndryshme të ndihmojë studentët për zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale. Nëpërmjet, Shoqatës UET Alumni, institucioni përpiqet të mbajë kontakte me studentët e diplomuar, duke organizuar aktivitete që kanë si qëllim ritakimin e të gjithë ish-studentëve dhe shkëmbim të eksperiencave tëtyre.<br>Bashkëpunimi me studentët e diplomuar shtrihet edhe në kërkimin shkencor, ku ish studentët ftohen për të publikuar artikujt e tyre në revistën shkencore Medicus apo të marrin pjesë me punimet e tyre në panelin e FSHMT, në Konferencën Ndërkombëtare që organizohet në UET “Ditët e Studimeve Shqiptare”. Studentet e ciklit MP Infermieri kanë qenë të pranishëm si dëgjues në panelin e Mjekësisë gjatë zhvillimit të saj. Programi MP ne Infermieri ka një numër të vogël studentësh (4studentë) pasi është viti i parë i studumit në këtë program dhe studentët janë në proçes të diplomimit, megjithatë FSHMT synon rritjen e numrit të studentëve në vitet në vazhdim dhe ndjekjen e traditës së UETpër ruajtjen e kontakteve dhe inkurajimin e edukimit të vazhduar të studentëve të diplomuar [takimi me stafin drejtues, akademik dhe dokumenti Trajnime te mëtejshme profesionale për studentët e diplomuar]<br>Dokumentin “Raporti i përfitimet nga marrëveshjet”, përmban informacionet që lidhet me ndikimin e këtyre marrëveshjeve në në bashkëpunimin midis personelit akademik dhe studentëve për shkëmbim eksperience, kërkimit, mobilitetit etj. Numri i studentëve në MP infermieri ka qenë i pakët për vitin akademik 2018-2019, vetëm 4 studentë dhe 11 student për vitin akademik 2019-2020, 6 prej të cilëve në MP me profilin “Infermieri kirurgjikale” dhe 5 në profilin “Infermieri në kujdesin Parësor Shëndetësor”, pasi programi MP në infermieri është një program i ri dhe viti 2019-2020 është viti i dytë akademik që funksionon dhe për këtë arësye nuk ka patur shkëmbime studentore në kuadër të programe të bashkëpunimit Erasmus. Pjesë e programeve të shkëmbimit të eksperincës janë edhe petagogët ku mund të përmëndet rasti i një petagogu nga FSHMT ka qënë në Universitetin Szczecin në Poloni si lektore për studentët dhe specilistë të mjekësisë.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</td></tr>
<tr><td>Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
</table>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al





| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER PROFESIONAL.

| **Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Master Profesional në Infermieri me profile Infermieri Kirurgjikale,Infermieri në Kujdesin Shëndetësor Parësor dhe Nutricion dhe Dietologji është hapur me UMASH nr. 336 datë 11.10.2018 me formë studim me kohë të plotë. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i infermierisë dhe fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore teknike dhe i referohet nivelit te 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe organizohet në 60 (ECTS) dhe kohëzgjatje 1 vite akademik, të ndarë në dy semestra, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Studimet përmbyllen me provim përfundimtar formimi, ose punim diploma dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master profesional" **[Rregullorja e programit te studimit, kurikula e programit]** Programi i studimit është organizuar në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*". |
| **Kriteri 2** Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Programi i studimit MP në Infermieri me profile, përban një informacion të plotë në fushën e infermieristikës dhe sidomos në profile më specifike si infermieri kirurgjikale apo infermieri në kujdesin shëndetësorë parësor. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive në fushat specifike dhe të specializuar të infermieristikës si dhe përftimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për ti shërbyer pacientëve me etike dhe kujdesje profesionale dhe zgjidhjen e situatave komplekse. Programi i studimit në përmbatjen e tij(sylabuset) përfshin tema specifike për profilet të vecanta që lidhen me nevojat e tregu të punës dhe ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucioni. **[programi, plani mësimor]** |
| **Kriteri 3** Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Njohuritë e fituara në këtë program studimi, i krijon mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës dhe zgjerimin e njohurive të tyre profesionale për kualifikime të mëtejshme. Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, pas përfundimit të këtij programi, studentët kanë fituar njohuritë dhe kapacitet e nevojshme profesionale për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike si dhe zgjidhjen e problematikave në praktikën e përditshme në fushën e infermierisë. **[takimi me** |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4** Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | **studentët]**<br>Programi i studimit MPMI është i organizuar me kohë të plotë në një vit akademik të ndarë në dy semestra në total 60 ECTS (ose 594 orë mësimore) nga të cilat 6 ECTS përkasin praktikës profesionale dhe 12 ECTS punimit të diplomës dhe provimit përfundimtar **[plani mësimor].**<br>Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të dy semestrat janë organizuar në leksione, seminare, praktikë profesionale si dhe orët jashtë auditorit. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm për studentin në masën 80%. Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta. **[Rregullorja e programit te studimit]**<br>Në semestrin e dytë, studentët ndjekin praktikën profesionale pranë institucioneve/qendrave shëndetësore publike dhe jo publike me të cilat institucioni ka lidhur kontratë/marrëveshje bashkëpunimi. **[marrveshjet, analiza e marrveshjeve]**<br>Lëndët e programit realizohen sipas orarit mësimor të ndarë në dy semestra.. Programi mësimor/kurikula e programit nuk janë të miratuar nga këshilli i fakultetit. |
| **Kriteri 5** Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Dokumenti i Rregullores së programit, programi mësimor, kurikula e programit, ngarkesa mësimore e stafit akademik nuk kanë datë, nr protokolli, vulë apo firmë të organit miratues **[Rregullorja e funksionimit të programit, kurikula e programit, plani mësimor, ngarkesa mësimore e petagogëve].**<br>Gjithashtu, GVJ konstaton se numri i ECTS/orët mësimore në auditor të paraqitura në planin mësimorë 594 orë (reale janë 540 orë) në auditorë në secilin prej tre profilet e studimit nuk përputhet me numrin e orëve në ngarkesën e plotë mësimorë të petagogëve të përfshirë në këtë program studimi(600 orë). Në ngarkesën mësimorë të petagogëve nuk reflektohet ngarkesa mësimore e praktikës profesionale **[plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e petagogëve të përfshirë në program ].** |
| **Kriteri 6** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Institucioni (FSHMT) ka një dokument të shkruar për llogaritjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik dhe konvertimit të ECTS në orë mësimore, por ky dokument nuk është i miratuar nga strukturat drejtuese dhe nuk përmban nr protokolli. Në kontratën individuale të punës në shtojcat nr 1 dhe nr 2 janë të përcaktuar ngrakesat e stafit sipas titujve/gradave akademike dhe konvertimi i orëve faktike në orë të realizuar/konvertuar, por jo konvertimi orëve në ECTS.<br>***Nga sa më sipër, GVJ rekomandon rishikimin e planit mësimor në të cilin të merren parasysh edhe gjetjet dhe konstatimet e mësipërme.*** |
| **Kriteri 7** Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në | Bazuar në ligjin Nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar titullari i lëndës duhet të jetë i Kategorisë Profesor. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni në të gjitha lëndët e zhvilluara në këtë program mungon titullari i lëndës. Sylabuset janë miratuar nga drejtuesi i njësisë bazë(drejtuesi i departamentit) dhe përgjegjësi i grup lëndëve.<br>Pjesë e programit të studimit MP në menaxhim infermieror është dhe praktika profesionale e cila është 6 ETC/150 orë mësimore dhe kryhen sipas programit kalendarik (**referuar dokumentit të planit mësimor**) që nuk përputhet më |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane. | përshkimin në RVB ( **RVB fq 13 : standarti 2.1 kriteri 7**).<br><br>Praktikat profesionale të studentëve kryhen në institucionet shëndetësore publike ose jo publike më të cilat UET ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi. Në dokumentin e dorëzuar për institucionet ku studentët e vitit të parë të MP në infermieri kanë kryer praktikën profesionale nuk ka patur kontratat bashkëpunimi të shkruara. Praktika profesionale mbikëqyret nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika dhe vlerësohet nga pedagogu mbikëqyrës, institucioni ku kryhet praktika si dhe një vetvlerësim nga studenti. Programi ka një rregullore të shkruar mbi organizmin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën. **[dokumeneti i praktikes profesionale, dokumenta e vleresimit të praktikës, takimi me stafin drejtues dhe stafin akademik ].** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | **X** | | |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi**. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.<br><br>**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.<br><br>**Kriteri 3**. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.<br><br>**Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën | UET është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, datë22.07.2015 “Për Arsimin elartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutusit të Universitetit Europian të Tiranës. Institucioni përbëhet nga organet drejtuese, bordi organizative, njësitë bazë të punës mësimore, njësitë ndihmëse mësimore dhe administrative, organet këshilluese dhe drejtuese, stafi akademik dhe administrata **[regulloja e UET]**.<br>Gjithashtu UET i ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar dhe ri akredituar në nivel institucional (vitin 2009 dhe 2017). Programet e studimit që ofron institucioni janë në proçes akreditimit periodik dhe janë akredituar nga institucionet përgjegjëse.<br><br>Programi MP në infermieri organizohet në departamentin e fizioterapise dhe infermierisë të FSHMT. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është i përbërë nga dy Departamente (Departameti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti i Imazherisë) dhe Qendra e kërkimit shkencor në Shëndet Publik. Afati normal për përfundimin e studimeve në Masterin Profesional Infermieri është 1(një) vit akademik.<br><br>Për vitin 2018-2019 në njësinë bazë për realizimin e programit, janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradën shkencorë apo Msc. Në njësinë bazë janë angazhuar 11 (njëmbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 7 (shtatë) janë staf akademik efektivë. Personeli akademik efektive përbën **63.6 % të stafit akademik për vitin 2018-2019** . Nga 11 anëtarë të stafit akademik 3 janë të |



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| akademike. | kategorisë professor, me titullin Prof. Dr dhe Prof. As; 1 me titullin Prof. Asoc. Dr. 7 Dr. Shk. dhe 1 Msc. Shtatë prej tyre janë personel me kohë të plotë dhe 4 me kohë të pjesshme.<br><br>Për vitin 2019-2020 në njësinë bazë janë angazhuar 15 (pesëmbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 7 (shtatë) janë staf akademik efektivë. Personeli akademik efektive përbën ***46.6 % të stafit akademik për vitin 2019-2020.*** |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. | Nga 15 anëtarë të stafit akademik 6 janë të kategorisë professor, (Prof. Dr/As prof; 2 Dr. shkencash, dhe 7 janë Msc.<br><br>***Në RVB dhe dokumentet e dorëzuar nuk jepen të dhëna për personelin akademik ndihmës.***<br>Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione punë. |
| **Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit mësimor-shkencor me kohë të plotë, për mbikëqyrjen e studentëve gjatë kryerjes së praktikës profesionale jashtë auditor dhe mirëmbajtjen e mjediseve laboratorike dhe shkollore. Kjo u konstatua gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor.<br>Personeli akademik dhe administrativ përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit sipas pozicionit të punës që kryhen dhe dëshmoi që ishte i angazhuar në përmbushjen e objektivave të programit. |
| **Kriteri 7.** Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit. | Programi ka një koordinator të emëruar me vendim Nr. 97, datë 03/ 12 /2018 të dekanit të FSHMT i cili është staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion.<br>Koordinatori i programit përgjigjet për realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale, kontrollon sylabuset sipas një formular verifikimi dhe raporton tek shefi i departamentit .<br><br>Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuar në rregulloren e funksionimit të UET . |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.3**<br>**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, | GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistem, gjatë vizitës në institucion dhe dokumentet shtesë pas vizitës në institucion **[dosja e programit]** konstaton së departamenti zotëron dhe disponon |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit., të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin ketë program studimi.<br>Referuar dokumentacioni të vënë në dispozicion, programi i studimit është organizuar në lëndë, praktikë profesionale dhe aktivitete formuese. |
| **Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | Në program është ruajtur raporti në % i shpërndarjes së veprimtarisë formuese në kategori të veçanta sipas përqindjes së përcaktuar në VKM 41 datë 24.1.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*". |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Programi i studimit MP në infermieri me tre profile është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në një vit akademik të ndara në 2 semestra. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Në njësinë bazë ku zhvillohet programi i ciklit të dytë të studimit MP në infermieri gjendet informacioni i nevojshëm lidhur me programin, ngarkesën mësimorë, orët në auditor dhe jashtë auditorit, mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe frekuentimin e programit, etj. |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | GVJ nga shqyrtimi i dokumentacion dhe vizitës në institucion konstaton se institucioni ka një informacion të plotë për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit **[regullorja e pergjithsme e UET, regullorjae programit]** |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programet e studimit të pranishme në departamentin fizoterpisë dhe infermirisë, ku realizohet ky program studimi, përmbajnë informacionin lidhur me syllabuset që zhvillon programi të ndara në leksione, seminare, orët brenda dhe jashtë auditorit. Nga shqyrtimi i dokumnetacionit GVJ konstatoi se :<br>- **sylabuset nuk janë hartuar në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*" , por**<br>**në to mungon titullari i lëndës i cili duhet të jetë i kategorisë profesor.**<br>- **mungojnë syllabuset për praktikën profesionle,**<br>**lëndët dietologji e aplikuar, këshillim edukim dhe terapi e të ushqyerit, diagnostikë nutricionale.**<br>- Syllabuset e lëndëve në përgjithësi përmbajnë<br>informacionin e nevojshëm si dhe literaturën që mund të shfrytëzoj studenti e cila është e 5 viteve të fundit. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe | Referuar këtij konstatimi, ***GVJ rekomandon që institucioni të rishikoj formatin e sylabuseve dhe hartimin e sylabuse që mungojnë (Standardi II.3)*** |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| arkivohet dosja e plotë. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.<br>**Kriteri 2**. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.<br>**Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.<br>**Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.<br>**Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kreditë **[bazuar në legjislacionin në fuqi, kurikula e programit].**<br>Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në krediteve (në %) për veprimtaritë formuese përputhet me legjislacionin në fuqi VKM 41 datë 24.1.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*".<br>Shpërndarja e ngarkesës mësimore në program përcaktohet nga vetë institucioni por GVJ nuk identifikoi metodologjinë e ndjekur në zbatim të Udhëzimit të MASR për ngarkesën mësimore në institucionet e arsimit të lartë.<br>Në dokumentacion e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në program por jo në departament. *GVJ nuk mund të llogarisë ngarkesën në orë dhe % që mbulohet nga PAE dhe PAK sepse në ngarkesën mësimorë nuk është e përfshirë praktika profesionale, ka mospërputhjes së ngarkesës mësimore të petagogëve me atë të planit mësimor, për dy lëndë të programit si Infermieristikë kirurgjikale e avancuar dhe Kujdes infermieror në sallë zhvillohen nga dy petagogë(PAE dhe PAK) por në ngarkesën mësimore nuk është përcaktuar sa orë kryhen secili petagog.*<br><br>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të infermieristikës. **[programi, rregullorja]**<br>Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale.<br>Me njohuritë e mara në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e mara janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre **[takimi me studentë].**<br>Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | kredite/orëmësimore përputhet me profilin MP në infermieri me tre profile. Gjatë takimin me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i ngjashëm me programe ndërkombëtare dhe pjesërisht i ngjashëm me programe të ngjashme kombëtare, **(Referuar takimit me stafin drejtues të UET dhe stafin akademik)** por e pa mbështetur në dokumente konkrete. Ndarja në kategori i veprimtarisë formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre, |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë. | bën të mundur arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e mara në këtë program dhe kurikula e tij ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privatë.<br><br>Institucioni, u ka ofruar mundësi studentëve mundësi për trajnime, kërkime |
| **Kriteri 8.** Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | dhe mobilitet të studentëve dhe petagogëve në institucione jashtë vendit në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me institucione të ndryshme ndërkomëbtarë, apo projekteve Erasmus . Në këto programe nuk ka patur studentë nga programi MP në infermieri sepse ky është program i ri që ka një vit që funksionon **[takimi petagogë, RVB]** |
| **Kriteri 9.** Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Përmbajta e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive të përftuara në ciklin e parë të studimit dhe profilizimin e tyre në një fushën më të ngushtë në atë të infermieri në kirugji apo shëndet parësorësor duke bërë të mundur përfitimin e aftësive, shprehive për të përfituar aftësitë e duhura kompetente të nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre.<br>Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që ju siguron studentëve informacionin e duhur për thellimin e njohurive në fushën përkatësë të infermieristikës. **[programi, rregullore, plani]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.5**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Personeli akademik i angazhuar në programin master profesional me profile përmbushin këkesat ligjore në fuqi. Ai përbëhet nga pedagogë me eksperiencë që kanë kualifikimin e duhur profesional për lëndët përkatëse që ata zhvillojnë në program.<br><br>Stafi akademik efektive dhe me kontratë i angazhuar për realizimin e |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të | programit të ciklit të dytë të studimit MP në infermieri për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020 zotërojnë tituj akademik dhe gradën shkencorë |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | doktorë.<br>Për vitin 2018-2019 në programin e studimit janë angazhuar 11 (njëmbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 8 (tetë) janë staf akademik efektivë. Personeli akademik efektive përbën **72.7% të stafit akademik për vitin 2018-2019.**<br>Nga 11 anëtarë të stafit akademik 3 janë të kategorisë professor, Prof.Dr/As prof; 8 Dr. shkencash. |
| **Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Për vitin 2019-2020 në programin e studimit janë angazhuar 12 (dymbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 7 (shtatë) janë staf akademik efektivë. Personeli akademik efektive përbën **58.3% të stafit akademik për vitin 2019-2020**<br>Nga 12 anëtarë të stafit akademik 9 janë të kategorisë professor, (Prof.Dr/As prof; 1 Dr. shkencash, dhe 2 janë Msc.<br>Për vitin akademik 2018-2019 raporti PAE/PAK është 8/3 (72.72% me 27.23%). Për vitin 2019-2020 raporti PAE/PAK është. 7/5 ( 58.34% me 41.6%). **[te dhëna tabelore për stafin akademik]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*". ngarkesa mësimore e studentëve gjatë një jave varion 20-25 orë mësimore.<br>Ngarkesa e stafit akademik bazohet në udhëzimin nr. 29/2018të Ministrit të Arsimit dhe ngarkesa maksimale që mbulojnë pedagogët në këtë program në orë mësimore nuk është më e lartë se ajo që parashikohet në udhëzim në përputhje me titullin apo gradën që zotëron petagogu, *por GVJ nuk ka informacion sa është ngarkesa e mesimore e tyre në departament.* ***Stafi akademik efektiv realizon reth 60% të ngarkesës mësimore në program dhe sic është përmendur dhe më lartë ka mospërputhje të ngrakesës mësimore në orë të stafit akademik deklaruar në dokumentin "ngarkesa e stafit akademik(deklaruar 600 orë)" dhe dokumentit "Plani mësimor" ku ngarkesa në orë është deklaruar 594 orë)*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Shumica e pedagogëve të angazhuar për vitin akademik 2018-2019 kanë përvojë të gjatë akademike dhe si mjekë klinicistë. Niveli i kualifikimit, ekspertiza dhe fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit përputhen me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve.<br>Për vitin akademik 2019-2020 për një pjesë të stafit nuk janë vënë në dispozicion CV e tyre për të konfirmuar nivelin tyre të kualifikimit dhe përputhjen me lëndët e programit që ata zhvillojnë në këtë program.<br>Në bazë të ekspertizës së tyre, anëtarët e departamentit janë përfshirë në Projektet e Mëdha Kërkimore që përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET, si senior research apo si anëtarë të këtyre grupeve **[referuar RVB].** Disa nga drejtimet kërkimore që |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | udhëhiqen nga stafi akademik i këtij programi udhëheq punën kërkimore me tematikat e më poshtëme:<br><br>•Sfidat Demografike dhe Strukturore ndaj Sistemit Shendetesor<br>•Morboziteti Infeksionet Hospitaliere dhe ne Njesite e Reanimacionit<br>•Aplikimi i Sistemit te Mjekut te Familjes<br><br>Institucioni për realizmin e praktikës profesionale dhe temave të diplomave të studentëve apo kryerjen e doktoratave dhe veprimtarive të tjera kërkimor shkencore, ka nënshkruar një sërë kontrata me institucionet arsimore dhe shëndetësore publike dhe private **[Referuar RVB]**, *por bazuar në dokumentacionin e vënë në dispoziocion sic është përmëndur edhe më sipër institucioni ka vetëm dy marveshje*.<br>Marrëveshjet e bashkëpunimit ndihmojnë në realizimin e praktikës profesionale, punimime diplomash dhe veprimtari të tjera specifike në përputhje me natyrën e programit të studimit si dhe për të ftuar ekspertë të fushës nga këto kompani apo institucione në auditor **[Referuar RVB].** Referuar RVB praktika mësimore mbikëqyret nga një petagog i cili u plotëson formularin e praktikës profesionale ku dokumentohen të dhënat për Institucionet si spitale, qëndra shëndetësore në rrethe etj, si edhe personat e kontaktit që mbikqyrin nga afër studentët e Infermierisë në vendin ku ata kryejnë praktikën profesionale **[refernca 32 nuk është dokumenti që referohet ne RBV fq 23].**<br><br>***Nga takimi me drejtuesit e institucioni dhe stafin akademik nuk ka personel ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e praktikës laboratorike sepse institucioni nuk ka ngritur ende laboratorët mjekësor mësimorë.*** **[vizita e ambienteve]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi II.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e | Institucioni i kushton një vëmëndje të rëndësishme hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit në bashkepunim të stafit akademik me përfaqësues të bordit të tregut të punës dhe studentët të cilat kanë si qëllim përshtatjen sa më të mirë të tyre me kërkesat e tregut të punës.<br>Gjatë takimit që patëm u paraqit vetëm një student i cili u shprehen së |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | dijet e fituara në program i kanë shërbyer në punën e tij të përditshme dhe rritjen e tij profesionale. |
| **Kriteri 2.** Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | Rishikimi i programit ashtu si dhe në degët e tjera kryhet duke ju referuar dhe kërkesave të tregut të punës për infermier të profilizuar. Në takimin me drejtuesit e UET dhe stafin akademik u deklarua se nevojat për infermier janë në rritje për shkak të largimit të tyre në emigracion.<br><br>*GVJ evidentoi dokumente dhe informacione që dëshmojnë këtë angazhim të partnerëve, bashkëpuntorëve dhe studentëve të diplomuar në hartimin e programit.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit. | |
| **Kriteri 4.** Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<table>
<tr><td colspan="5">Standardi III.1<br>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td colspan="4">Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</td><td colspan="4" rowspan="5">UET ka hartuar disa rregullore për funksionimin e institucionit dhe programit të studimit të miratura nga titullari i institucionit [rregulloret]. Rregullorja e programit të studimit, përcakton elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive.<br>GVJ në takimin me stafin akademik konstatoi se në program e studimit zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me ato online. [takimet me stafin dhe studentët].<br>Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni ka në funksionim NJSBC e cila në bashkëpunim me Zv/ Rektorin për Procesin Mësimor, Dekanët, Drejtuesit e Departamentit dhe Sekretarinë e Përgjithshme kryhen monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik dhe administrative.<br>Komisioni monitoron dhe vlerëson në mënyre periodike procesin mësimor, aftësitë e stafit akademik bazuar në pyetësorin e studentëve, ndjekjen e orëve mësimor në auditor, aktivitetin e tyre shkencor si dhe kontributin e tyre ne funksion të institucionit si dhe intervistës individuale me secilin petagogtë brëndshën apo të jashtëm lidhur me kryerjen nga pedagogu të të gjitha detyrimeve kontraktuale me cilësinë dhe sasinë e duhur [RVB, takimi me stafin akademik, formularët e vlerësimit].<br><br>Institucioni në mënyrë periodike çdo vit vlerëson metodat e mësimdhënies nëpërmjet realizimit me sondazh/fokus grup të plotësimit të pyetësorit të vlerësimit nga studentët. Studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik. Rezultatet për vlerësimin e dhënë nga studentët bëhën publike për të gjith stafin akademik në formë të personalizuar.Rezultatet dhe informacionet e marra nga sondazhet i shërbejnë përmirësimt të punës në institucion dhe të stafit akademik, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe zbatimit të metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve.<br>Për promovimin e shëmbujve dhe praktikave më të mira institucioni përdor mënyra të ndryshme si trajnime të stafit akademik për rifreskim të njohurive lidhur me kërkesat dhe standartet e cilësisë, metodat e mësimdhënes, etj.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</td></tr>
<tr><td>Shkalla e përmbushjes së</td><td>Nuk</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
</table>



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1**. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Në realizimin e procesit mësimor UET përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti **[RBV, takimime tafin akademik].**<br>Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Poëer Point, biseda interaktive me studentët apo temave të vecanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafi akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimit apo praktikës mësimore.<br>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre ne funksion të formimit të tyre profesional teorik por mungojnë laboratorët mjekësorë të nevojshem per zhvillimin e praktikave laboratorike mësimore .<br>Personeli akademik (për petagogët që janë në dispozicion CV) i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperincë mjeksorë apo petagogjike në lëndët që zhvillon. ***GVJ nuk ka ne dispozicion CV për të gjithë petagogët e përfshirë në programin e studimit .***<br>Institucioni vlerëson në mënyre periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit. **[pyetësore me studentët]**<br>Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin stafi akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie si me anë të projektorëve, prezantime pour point, metoda interaktive apo metodat online duke shfrytëzuar sistemin LSM që janë të përdorshme si për studentët dhe petagogët. Sic është theksuar edhe në standartet e mësipërme IAL nuk ka infrastrukturën e nevojshme laboratorike për realizimin e praktikave mësimore laboratorike.<br><br>Gjatë procesit mësimor dhe praktikës profesionale apo punimit të temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët e tyre si në zgjedhjen e temës apo hartimin e saj duke gjetur tema të lidhura me problematika kryesorë të shërbimit shëndetësor sidomos në specialitet që përputhen dhe me profilet e këtij programi studimi si :<br>• Sfidat Demografike dhe Strukturore ndaj Sistemit |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Shendetesor.<br>• Morboziteti Infeksionet Hospitaliere dhe ne Njesite e Reanimacionit<br>• Aplikimi i Sistemit te Mjekut te Familjes<br>•<br>**[takimi me stafin akademik dhe student].** |
| **Kriteri 5.** Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | Institucioni ka siguruar hapësira të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat janë të mjaftueshme, të pastra dhe të mirëmbajtura, të pajisura me sistem kondicionimi dhe ndriçimin e duhur. **[vizita e ambienteve]** |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave. | Ambiente ku zhvillohet procesi mësimor kanë logjistikë e nevojshme, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjuter dhe projektorë për zhvillimin e mësimit, tabela shkrimi të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies **[vizita e ambienteve], por mungojne laboratorët mjekesore për realizimine praktikave mësimore** |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë | Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe pedagogeve burime të |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. | ndryshme informacioni si internet, referenca për literaturë në gjuhë të huaj në formë elektronike, sistemin online UMS dhe LMS ku ata mund të gjenë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, leksionet, librat si dhe literaturën e nevojshme, por literatura në gjuhën shqipe në formën hard copy është e pakët/minimale. ***Instutucioni nuk siguruon leksione të shkruara / të printuara për programin e studimit për të kompesuar mungesën e literaturës në gjuhën shqipe.*** |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | **[Sylabuset, Infrastrukturën]**<br>Në fund të çdo syllabusi studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë ne gjuhën shqipe apo të huaj që i përgjigjet temave të programit mësimor **[format syllabusi]. (Literatura e vënë në dispozicion të studentëve është e pesë viteve të fundit)** |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Institucioni ka në funksion të studenteve dhe personelit akademik bibliotekën. Gjatëvizitës GVJ konstatoi se literatura në funksion të këtij program studimi është e pakët dhe e pamjaftueshme. Ndërsa mungon literatura në gjuhën shqipe pavarësisht pranisë në formë elektronike të një numri të shumtë titujsh. Gjithashtu mundësia e shfrytëzimit të kësaj litearure nga studentët është e kufizuar pasi shumica e këtyre titujve nuk përbën literaturën bazë studimore dhe janë në gjuhë të huaj. Institucioni publikon listën e librave të rinj që hyjnë në bibliotekë, oraret e shfrytëzimit të ambienteve të bibliotekës nga studentët apo stafi akademik **[vizita e ambieteve ne institucion].** |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Institucioni i siguron Studentëve dhe pedagogeve mundësi aksesimi ne librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë. |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Në lidhje me infrastrukturën on line, institucioni ka faqen zyrtare të institucionit në të cilën publikohen informacione dhe njoftime të ndryshme.<br><br>Për mënyrën e përdorimit të sistemit online , institucioni ka dhe udhëzuesit përkatës në funksion të studentëve dhe stafit akademik. |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Nga takimet me stafin, studentët, sekretarinë dhe burimet njerëzore, rezultoi se institucioni ka në përdorim sistemin e menaxhimi të informacionit, sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore apo platformë në funksion të mësimdhënies on line dhe në distancë sipas përcaktimeve të Standardit III.3.<br><br>***Institucioni nuk ka strukturën e nevojshme laboratorike për shkencat mjekësore në funksion të studentëve dhe stafit akademik për realizimin e detyrave të kursit apo temave të diplomës.*** |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të | Temat e diplomës zgjidhen nga studentët në konsultim me pedagogët e tyre |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | në mënyrë që temat e tyre të jane lidhur me problematikat aktuale të sistemit shëndetësor, të jenë në funksion të përgatitjes së tyre profesionale dhe mundësive aktuale për realizimin e pjesës eksperimentale të tyre. Institucioni ka një rregullore për procedure e zgjedhjes dhe miratimit të temës së diplomes dhe vleresimin e saj .**[dokumenti punimit të diplomës dhe doktoraturës]** | | | |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | **X** | | |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Instritucioni ka të organizauar me akte rregullatore mënyren e funksionimit të UET/Fakulteteve/departamenteve të cilat janë në funksion të organizmit të mësimdhënies në programe të ndryshme që ka UET. Njësitë kryesore që asistojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë janë NJSBC dhe zyra e projekteve për Kërkim dhe Zhvillim përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshihet stafin akademik<br><br>Institucioni ka NJSBC e cila është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. **[rregullore NJSBC].** Kjo njësi harton plan pune që miratohet nga Rektori i UET dhe e ndjek atë në vitin pasardhës **[Plani i punës].** Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shërbejnë dhe leksionet e hapura të organizuar nga departamentet, pjesëmarrja e lektorëve të jashtëm nga fusha e biznesit, trajnimet periodike të stafit akademik.<br>Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike është njësia përgjegjëse për realizimin e procesit mësimor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së tyre dhe përmirësimin e programit të mësimit në MP në infermieri me profile.<br>Institucioni nëpërjet NJSBC në bashkëpunim dhe njësitë bazë ku zhvillohen programe të ndryshme të studimit, siguron një program trajnimi për stafin akademik në përputhje me kualifikimin e tyre dhe gradën shkencore. Këtij qëllimi i shërbejnë aktivitetet si Staff Development Day – me qëllim trainimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë. Cdo vit në fillim të vitit akademik Universiteti organizon edhe trajnimin dy ditor "Back to ëork". Gjithashtu, personeli akademik përfiton nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.<br>**Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.<br>**Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.<br>**Kriteri 8.** Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. | dijeve.<br>NJSBC në mënyrë periodike bën vlerësimin e sylabuset, literaturën, provimet dhe jep rekomandimet e nevojshme për përmirësim [**formulari vlerësimit].**<br>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes:<br>a. vlerësimit të Dekanit, Përgjegjësit të Departamentit dhe/ose përgjegjësit të grup-lëndës përkatës;<br>b. vlerësimit të studentëve që kryhet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatin e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit;<br>c. vetëvlerësimit;<br>GVJ identifikoi se Institucioni mbështet angazhimin e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, realizimit të konferencave të përbashkëta me IAL të tjera apo kompani biznesi, mbështetja me bursë për realizim të temave të doktoraturës në kuadër të projekteve të bashkëpunimit që kanë me institucione jashtë vendit, realizimin e botimeve në buletinin shkencorë të fakultetit **[takimi me stafin drejtues dhe akademik],[revista e medicus]** Institucioni realizon takime apo konferenca të veçanta që shërbejnë për shkëmbim eksperience dhe shpërndarje të informacionit duke ftuar profesorë të huaj apo lektorë nga bota e biznesit. Këto aktivitete i shërbejnë përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë.<br>*GVJ vëren që aktivitetet në fushën e infermieristikës janë të pakta për faktin se ky program studimi është i ri dhe ka vetëm një vit që funksionon.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe | Institucioni zotëron gjith bazën e nevojshme ligjorë që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve te |

| | |
|---|---|
| aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët qënë fillim të vitit akademikdhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion në platformën LMS **[regulloret e funksionimit te FSHT dhe programit të studimit ]** |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të FSHM si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve. |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme<br>Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare. Procedura e provimeve kryhet në bazë të rregullores " Për zhvillimin e provimeve të miratuar nga senati. **[rregullore e provimeve]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm.<br>Nota përfundimtare bazohet në shumatoren e rezulatateve që student mer gjatë gjith vitit akademik si vijon:<br>a. Provimi i ndërmjetëm (30%)<br>b. Niveli i diskutimit (10%)<br>c. Detyrë kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike (20%)<br>d. Provimi përfundimtar (40%). |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Shkalla e përvetësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me shkrim dhe / ose me gojë ose me temë diplome sipas rregulloreve të funksionimit të programit dhe në përputhje me specifikën e lëndës bëhet në bazë pikëzimi 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 deri në 10.<br>Mënyra dhe sistemi i vlerësimit ju komunikohen studentëve në fillim të procesit mësimor. |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar | UET përdor programin turnitin/ephorous që prej 16 tetor 2015 për të evituar plagjaturën e eseve dhe temavetë diplomës **[RBV, takimi me stafin akademik]** |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| me personel dhe mjete survejimi. | Tesimi i dijeve përfundimtarë realizohet nga petagogu që ka zhvilluar programin. GVJ nga verifikimi me sondazh i fletëve të provimit dhe takimi me përfaqësuesit e kurikulave konstatoi ***se ka lëndë që provimi zhvillohet nga një petagog dhe jo me komision të përbërë minimumi nga dy anëtare [stand 3.6]***<br>Testimi i dijeve kryhet me shkrim, në mënyrë anonime me sekretim. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë/kordinatorit dhe komisionit të provimit.<br>Vlerësimi i studentit me pikë është i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit, me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëvedhe firmoset nga pedagogu që ka bërë korrigjimin. **[Rregullore e UniversitetitEuropian të Tiranës (Neni 27 Provimet, regullorja e programi të studimit]**<br>Student kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. procedura e shqyrtimit të ankesës përcaktohet në regullorene provimeve.<br>Sekretaria është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë apo komunikimi midis studentëve. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës.<br>Student shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. **[takimi me studentët]**<br>Për çdo provim pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejte të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës sipas procedues të miratuar në rregulloren përkatës të provimit.<br>Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit të ngritur në rang departamenti. E gjithë procedura dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranëSekretarisë Mësimore, dhe në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | |
| **Kriteri 8**. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë | Programi i studimit të ciklit të dytë MP në menaxhim infermieror është 1 vit akademik, 2 semestra dhe ka 60 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta. |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| profesionale dhe të veçanta të studentëve. | 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione seminare, detyra kursi, apo prezantime apo praktika. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Në përfundim të studimeve të ciklit të dytë të studimeve, studentët pajisen me diplomë Master profesional me emërtimin: MP në infermieri, profili infermier kirurgjie etj. Bazuar në Rregulloren e Programit të studimit, diploma mbrohet me punimin e një mikroteze diplome. Diploma i jepet studentit që ka kryer të gjitha detyrimet e programit mësimor, detyrimet finaciare ndaj UETsi dhe mbrojtur mikrotezën. |
| **Kriteri 3**. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | Masteri professional në Infermieri synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin përkatës dhe të formojë infermierë me kompetencën e nevojshme profesionale teorike dhe praktike në specialitetitet kirurgji, kujdes shëndetësor parësor, për realizimin e misionit të infermierit në fushën përkatëse. Gjithashtu një element i rëndësishëm i programit është pajisja e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe kërkimit për të cilën zhvillohet dhe një lëndë e vecantë në kurikulën e programit. **[kurikula e programit].** *Nga shqyrtimi i sylabuseve GVJ konstatoi se në profilin dietologji nuk ka sylabuse pasi në këtë profil nuk është paraqitur asnjë student për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-20202.* |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. | Në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme orën e fundit të mësimit, pedagogu si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Gjithashtu pedagogu ndalet në vecanti në temat që kanë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëdës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me këkrkesë të studentët sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit gjatë orarit zyrtarë të punës. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kane mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Në programi MP në infermieri me tre profile janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit që mbulon lëndët karakterizuese të kategorisë B, janë Mjekë specialistë të fushave përkatëse dhe kompetentë në këto fusha. Në lëndët e zhvilluar bazuar në CV e stafit kademik që u vunë në dispozicion, fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me sylabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies. Sic është përmendur dhe në standartin 2, GVJ nuk pati në dsipozicion CV për të gjith stafin e përfshirë në mësimëdhënie, |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Dijet e mara, aftësitë dhe kompetencat e përfituar gjatë realizimit të programit të studimit vlerësohen në përfundimin e lëndëve përkatëse me sistemin e notave nga 4 (katër) deri në 10 (dhjetë), ku nota 5 është nota minimale kaluese |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | dhe 10 është nota maksimale, ndërsa mikroteza vlerësohet me sistem pikëzimi. **[regullorja e programit].** Studenti përvec regullores së provimeve në fund të çdo syllabusi gjen të detajuar format e vlerësimit ku një vëmëndje e veçantë i është kushtuar edhe njohurive të marra në praktika profesionale që realizohen për nivelin e studimeve Master Profesional. |
| **Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentë në bashkëpunim me pedagogët. Këtij qëllimi i shërbejnë angazhimi që UET ka me programet Erasmus + për mobilitetin e studentëve dhe të stafeve akademike **[lista e projekteve dhe bashkëpunimeve].** |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Programi Master në infermieri është një program i ri, i hapur vitin e fundit dhe kjo përbën shkakun që ende nuk ka mobilitet të mbështetur nga Erasmus për këtë program studimi. Por në kuadërtë të shkëmbimeve të personelit akademik në universitetet partnere perëndimore në kuadër të programeve Erasmus + KA1 një pedagoge e FSHMT ka qënë në universitetin të Poloni për të dhënë mësim dhe leksione në shkecat mjekësore. Këto bashkëpunime mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitiminprej praktikave më të mira, të cilat më tej përshtaten nga personeliakademik pas rikthimit në UET duke u shpërndarë dhe tek kolegët e tjerë në institucion. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Për realizimin e praktikës profesionale institucioni ka lidhur marrëveshje me institucione shëndetësore publike dhe private duke ju siguruar studentëve që të kryejnë praktikën profesionale në institucione shëndetësore. **[marrveshjet kombëtare]**<br><br>UET garanton kryerjen e praktikës profesionale në institucione shëndetësore publike dhe privatë në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me to duke ju krijuar mundësi studentëve të fitojnë shprehitë të punës praktike dhe të familjarizohen me to, si dhe të krijojnë kontakte me stafin mjekësor dhe infermieror duke bërë të mundur dhe realizimin e mikrotezës së diplomës. Studentë kryejnë praktikën jo vetëm në spital/spitali traumës po dhe në strukturat e shërbimit parësor, pranë |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | mjekut të familjes **[dokumenti institucionet bashkëpunuese], *por si është përmndur edhe më lart institucioni nuk ka të dokumentuar të gjitha marrëveshjet me institucionet ku studentët kryejnë pratikën profesionale.*** Programi i studimit MP në infermieri, në tre profile ka 60 ETC përfshirë dhe praktikën profesionale. Praktika profesionale ka 6 kredite. Në përfundim të zhvillimit të praktikave profesionale, pedagogu që e mbikëqyr studentin gjatë praktikës dorëzon te Koordinatorja e departamentit formularin e vlerësimit të studentit, formularin e vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi i institucionit ku ka kryer praktikën profesionale, formularin e vetëvlerësimit të plotësuar nga studenti dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës. Vlerësimipërfundimtar i studentit bëhet përpara një komisioni. ***Programi nuk ka një syllabus në bazë të të cilit realizohet praktika.*** |
| **Kriteri 3**. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi III.9**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Studenti në fund të studimeve pajiset me diplome MP në infermieri, profili infermier ne kirurgji, kujdes shëndetësor, dietologji" pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimi të temës së diplomës. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në regulloren e UET dhe të programit të studimit. **[rregullorja e diplomimit, regullorja e punimit të diplomës].**<br><br>Fokusi i programit MP në infermieri me profile, është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në përgatitjen e një teme studimor. Temat propozohen nga departamenti dhe lista e tematikave të propozuara i paraqiten studentëve dhe udhëheqësve të tyre. Zgjedhja e temës e cila ka karakter aplikativ/praktikë bëhet nga student dhe pedagogu udhëheqës. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.<br><br>**Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.<br><br>**Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.<br><br>**Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.<br><br>**Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.<br><br>**Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen. | Provimi i përgjithshëm përfundimtar është konceptuar si një rast studimor kompleks që duhet të zgjidhet nga studenti për 150 minuta (koha e provimit). Ky studim lidhet ngushtë me profilin që ka studjuar studenti dhe njohuritë që ai ka përftuar në këtë program studimi.<br><br>Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga pedagoget ndihma e të cilëve konsiston në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit, shkrimit apo prezantim e studimit.<br><br>Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara komisioni të propozuar nga departamenti dhe miratituar nga Dekani i fakultetit. Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen nga komisioni me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit.<br><br>Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Diplomave është përfundimtar dhe nuk mund të ankimohet.<br><br>Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizmin e pjesës teorike të temës së diplomës infrastrukturën e nevojshme si dhe ju garanton studentëve mbledhjen e të dhënave apo realizimin e testeve të ndryshme në funksion të temës në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi **[infrastruktura], [marrëveshjet kombëtare]**. Ky informacion bazohet ne takimin me stafin akademik. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UET-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm brenda 6 (gjashtë) muajsh. Deri në pajisjen me diplomë të të diplomuarve, UET-i lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave<br><br>Në përfundim të studimeve në këtë program studentit pajisjet dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin edytë të studimeve në MP për infermieri me profile. **[programi i stud]**<br><br>Dokumentacioni lidhur me studentët ruhen nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet **[rregullore e sistemit te menaxhimit]** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, ASCAL. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi IV.1<br>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</td><td rowspan="3">Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se UET disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “MP Infermieri” me tre profile. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik e cila mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. [dokumentacioni i verifikuar në mënyrë rastësore].<br>Institucioni ka vene ne disponon listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore.<br>Nga verifikimi i dokumentacionit ne sistem dhe dokumentacionit të marrë në instucion GVJ konstatoi këto problematika:<br>a. CV e stafit akademik janë të papërditësuara.<br>b. Disa prej CV -ve të stafit akademik pjesë e departamentit pergjegjës të programit për vitin akademik 2018-2019 nuk ndodhen në sistem.<br>c. Pjesa më e madhe CV-ve të stafit akademik pjesë e departamentit përgjegjës të programit për vitin akademik 2019-2020 nuk ndodhen në sistem.<br>d. Një pjesë e CV- ve të stafit akademik te angazhuar ne program per vitin 2019-2020 nuk na janë vënë në dispozicion.<br>e. Disa anetarë të stafit akademik PAE të Departamentit Infermieri dhe Imazheri për vitin akademik 2018-2019 deklarojnë në CV që janë të punësuar me kohë të plotë në një institucion shtetëror.<br>f. Gjatë vizitës në institucion na u deklarua që disa anëtarë efektive të stafit janë larguar nga institucioni, perkatesisht 3 PAE, pas kërkesës sonë na janë vënë në dispozicion të dhëna për stafit akademik të njësisë bazë përgjegjëse të programit, për vitin akademik 2019-2020, GVJ evidenton ndryshime në një masë shumë të madhe si të sfatit akademik efektiv ashtu dhe të atij me kontratë.<br>g. GVJ ve re se një pjesë e anetarëve të stafit akademik te angazhuar ne program per vitin akademik 2019-2020 (dokument i marrë në insitucion) nuk përputhen me stafin e deklaruar të njësisë bazë Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi si të vitit paraardhës, 2018-2019 ashtu dhe të vitit akademik 2019- 2020 (dokument i vënë në dispozicion pas vizitës në institucion).<br>h. Gjatë bisedës me stafin akdemik u vunë re paqartësi në lidhje me</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</td></tr>
</table>



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | ***kohëzgjatjen e kontratës për PAE,*** ku deklarimet e tyre nuk përputheshim me deklarimet e koordinatorit të zyrës së kurrikulës.<br>**i.** Në kontratë përcaktohej ngarkesa mësimore për vitin akademik përkatës, por nuk deklarohej dhe kishte paqartësi se në cfare dokumenti bazohej shperndarja ngarkeses e cdo anetari te stafit akademik, ky dokument na u vu dispozicion pas kërkesës sonë në institucion.<br>**j. GVJ vë re qe ngarkesa mësimore (sipas dok 12, dokumenta shtese) është relativisht e lartë.**<br>Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme, GVJ konstaton mosqëndrueshmëri të stafit akademik, papërputhshmëri të stafit të njesise bazë me stafin e angazhuar në program dhe paqartësi në nenshkrimin e kontratave dhe shperndarjen e ngarkesës.<br>Nga sa më sipër **GVJ rekomandon hartimi e një procedure të qartë dhe te rinovuar e cila te bazohet edhe ne përcaktimet e IAL edhe ne Udhëzimit 29 për ngarkesën mësimore për personelin akademik (Standardi IV.1) Gjithashtu institucioni të angazhohet në plotësimin dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit veçanërisht CV dhe aktivitetit të tyre kërkimor e shkencor.**<br>Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore të institucionit GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.<br>Institucioni disponon rregullore në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UET **(Rregullore për Burimet Njerëzore)**. Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga UET. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës.<br>Institucioni ka hartuar procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike në faqen zyrtare të institucionit dhe rrjetet sociale. Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim. Këto procedura janë të përcaktuara në dokumentet e brendëshme të institucionit UET **(Rregullore për Burimet Njerëzore)** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficente dhe efektive** |
|---|


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | UET ka siguruar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin e me qëllim kryerjen detyrave në procesin mësimdhënës dhe shkencor **[Dok 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit].**<br>Institucioni boton revistën shkencore (Revista Medicus e specializuar në fushën e shkencave mjekësore) *por GVJ nuk evidentoi aktivitete të tjera shkencore si konferenca, symposiume etj. në fushën e mjekësisë.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Nga takimi me personelin akademik, personeli akademik shprehet se Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre por ndërkohë nuk u evidentuan raste konkrete të këtij angazhimi në mbështëtje të zhvillimit profesional dhe akademik veçanërisht për përsonelin akademik i cili mbulon dhe administron programin e studimit programin MPMI. **[takimi me personelin akademik].** |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | ***GVJ evidenton që personeli akademik i cili mbulon programin e studimit, ka një aktivitet shkencor të pasur si në botime shkencore ashtu dhe në prezantime në aktivitete te ndryshme të shkencave mjekësore, por këto aktivite janë produkt më tepër të investuara përsonalisht sesa më edhe me kontributin e institucionit.***<br><br>Ne RVB theksohet se institucioni është përfshirë në një sërë projektesh, të financuara nga donatorë të ndryshëm, dhe me partnerë nga vendet e BE-së dhe rajoni, ***por GVJ evidenton që asnjëri prej këtyre projekteve nuk i takon fushës së studimit të mjëkësisë ti dedikohet zhvillimit profesional të pedagove që mbulojnë këtë program studimi.*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimi të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | UET ka ndërtuar skemën e financimit të kërkimit shkencor, duke krijuar një fond prej 75.000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters. Nisma më e fundit e UET është krijimi i një Grupi Kërkimi Ndërdisiplinor prej 10 profesorësh të disiplinave të ndryshme, të cilëve iu është akorduar një fond vjetor për kërkim shkencor, prej 5.000 euro/secili.<br>Deri me tani asnjë nga pedagoget e shkencave mjekësore nuk ka përfituar nga ky fond.<br>UET organizon cdo vit trajnim për stafin akademik për prezantimin e tyre mbi teknologjitë më të reja si dhe njoftohen cdo jave me anën e një neësletter nga Zyra e Projekteve ne UET mbi projektet dhe trajnimet që mund të realizohen nga stafi. (takimi me stafin) ***Institucioni nuk ka vënë në dispozicion dokumntacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve***<br>***GVJ rekomandon që institucioni të angazhohet në krijimin e mundësive për kualifikimin e vazhdueshëm dhe krijimin e mundësivë për zhvillimin shkencor të personelit akademik i cili mbulon shkencat mjekësore në përgjithësi dhe programin MPMI në vecanti .*** |

| **Shkalla e përmbushjes së** | **Nuk** | **Përmbushet** | **Përmbushet** | **Përmbushet** |
|---|---|---|---|---|



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Standardi IV.3<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.<br>Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking.<br>Ambjentet janë me sistem kondicionimi dhe sistem ëireless, nyje hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion**.** GVJ vizitoi auditorët mësimorë ku sallat e leksioneve te organizuara ne forme amfiteatri ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet, tabela dhe foni. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit**. [vizita e ambienteve]**<br><br>Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim.<br>***Institucioni nuk dispononte laboratorë mësimore mjekësore dhe kabinete në funksion direkt të zhvillimit të programit mësimor, gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi ambjentet që institucioni kishte vëne në dispozicion të ndërtimit të laboratoreve mesimorë mjeksorë për të cilët u deklarua që paisën në një të ardhmë të afërt. [vizita në institucion]***<br>Laboratorët e informatikës ishin të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor **[vizita në institucion]**<br>UET ka aktualisht në përdorim 3 laboratorë mësimorë Informatike, 33 salla mësimore (leksione dhe seminare) janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit | |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| që ofron. | Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale sipas programit të studimit UET përcakton procedura të detajuara të aplikimit, realizimit , ndjekjes dhe vlerësimit. UET ka marrëveshje bashkëpunimi me QSUT dhe një kontratë qeraje më Spitalin Amerikan. ***GVJ vë re që shumica e studenteve nuk e kanë kryer praktikën mësimorë në këto institucione por në insutucione të tjera shëndetsore me të cilat UET nuk ka marrëveshje të dokumentuara bashkëpunimi.*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutera dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjeti Ëireless, , duke siguruar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.<br><br>Biblioteka ka krijuar një Katalog me libra elektronik në gjuhë të huaj, i cili ka qindra tituj librash në bazë të programeve të studimit dhe që u vjen në ndihmë studentëve të të gjitha niveleve të studimit. |
| Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | ***Literatura fizike në funksion të programit ishtë shumë e kufizuar dhe minimale. Literatura në gjuhën shqipe është pothuajse e munguar, panvarësisht numrit të lartë të titujve në formë elektronike mundësia e shfrytëzimit të tyre nga studentët është e kufizuar pasi shumica e këtyre titujve nuk perbëjnë literature bazë studimorë dhe janë në gjuhë të huaj.***<br>***Instutucioni nuk kishte siguruar leksione të shkruara / të printuara për programin e studimit për të kompesuar mungesën e literaturës në gjuhën shqipe.*** |
| Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: EBCSO, Emerald, Cambridge University, Taylor & Francis, Questia. |
| Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë | Biblioteka është e pajisur me poste internet, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.<br>Gjatë vizitës në institucion u evidentua se institucioni zbatonte plane të detajuara në lidhje më procedurat e shtimit të titujve ne |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| studentëve. | biblioteke me qellim pasurimin literaturë mjekësore bashkëkohore. **(Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë (Ref.Nr.45.2)** |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | |
| Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për student dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara dhe janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. nga e Hëne-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00:17:00. Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëne-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur. Institucioni nuk ka punonjës të veçantë për bibliotekën. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | **UET** disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin UMSI **(Manual i përdoruesit të sistemit UMIS) .** Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, informimin për aktivitete të ndryshme etj.<br>Sistemi i brëndshëm UMIS shërben edhe për administrimin e informacionit në lidhje me aktivitetin akademik të stafit dhe personelit administrativ. Institucioni ka vënë në dispozicion të studenteve dhe stafit të angazhuar në program, sistemin e menaxhimit të mësimdhënies online LMS, studentët dhe pedagogët në këtë sistëm kanë akses të dedikuar në lëndët dhë informacionet që u takojnë. Sistemi mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemin nga studentët.<br>Sistemi I menaxhimit te mesimdhënies on line ofron<br>informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog duke lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të |
| **Kriteri 2**. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e | |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| programit të studimit. | studimit dhe informacionit mes pedagogut dhe studentëve dhe kontribuar në rritjen e cilësisë së mësimnxënies.<br>Platforma LMS (Learning Management System) funksionon si një mjet efiçent në dispozicion të organeve drejtuese dhe titullarët, për të monitoruar në kohë reale mbarëvajtjen e procesit të akademik dhe admistrativ.<br>Faqja Zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës (UET) në ëeb është: ëëë.uet.edu.al. Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organigramën . Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, botimet e UET-Press-it si dhe shërbime të tjera që ofrohen nga UET-i. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi Guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet dhe sylabuset e lëndëve.<br>**Faqja zyrtare në Ëeb aktualisht është vetëm në gjuhën shqipe. Ne RVB deklarohet se institucioni në një moment tjetër do ta paraqëse dhe në gjuhën angleze.** |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ nuk ka dispozicion dokumentacion në lidhje me menyrën e administrimit financiar të institucionit, në RVJ deklarohet se Buxhetimi financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm Z. Henri Çili. Për zbatim të këtij buxhetimi, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës.<br>**GVJ nuk iu vunë në dispozicion të dhëna mbi procedurën e hartimit të buxhetit, alokimin dhe realizimin e tij në nivel institucional dhe të programit të studimit.**<br>**GVJ nuk iu vunë në dispozicion raporte financiare në bazë institucion apo në bazë programi.** Në RVB deklarohet se keto raporte |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit | |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | hartohen vetem ne rang institucioni.<br>Dokumentet e vetme që janë vënë në dispocion janë : dok 50 Të ardhurat nga financime të ndryshmë dhe dok 49 të dhëna për koston e studenteve, ku nuk silesohet kostaja e studetevve në programin përktës. **GVJ nuk ka të dhëna në lidhje me shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit**.<br>Institucioni deklaron se kryen auditin të pasqyrave financiare të përvitshëm, **në dispozicion të GVJ nuk janë vendosur as pasqyra apo raporte financiare dhe as raporte auditimi.**<br>Edhe në RVB, informacioni mbi analizën financiare për mbarëvajtjen dhe ecurinë e programit të studimit është jo i plotë.<br><br>UET është një institucion privat i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Në dokumentet shoqëruese deklarohet se burime të financimit janë tarifat e studentëve (regjistrimit dhe shkollimit) , grantet për kërkim dhe aktivitetet tregtare (qeradhenie, parkim etj.).<br>GVJ nuk identifikoi analiza mbi të cilat të jenë hartuar politika apo ndërhyrjet e posaçme në buxhet për diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij për vitet në vijim.<br>**Pavarësisht se në RVJ deklarohet se institucioni ka qëndrueshmëri financiare, në mungesë të të dhënave konkrete dhe të një analize financiare, GVJ nuk mund të dali në një konkluzion të saktë në lidhje me garantimin e një ecurie afatgjatë të institucionit dhe programit të studimit në veçanti.** |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | |
| **Kriteri 5**. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi V.1<br>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</td><td rowspan="3">UET është institucion jo publik i cili bazon aktivitetin e vet në bazën ligjore aktuale në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin dhe rregulloren. Edhe për administrimin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, në këto akte janë parashikuar procedurat e regjistrimit, mësimdhënies, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit. (dok. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Rregullore mësimore MP)<br>Në rregulloren mësimore të MP pohon se përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës (Referuar pika 2, Pranimi në programin e studimit, Rregullorja mësimore MP).<br>Në fazat e regjistrimit, institucioni publikon kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve duke garantuar transparencë [Rregullore UET, Neni 42].<br>Kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online, i bëhen të ditura të interesuarve gjatë vizitës në institucion, sikurse dhe gjenden në aktet rregullatore të cilat i vihen në dispozicion studentëve. Numri i studenteve qe ndjekin këtë program studimi është më i vogël se kuotat, program ka vëtëm një vit që është hapur dhe institucioni nuk ka përcaktuar kritëre të vëcanta për pranim. Politika e pranimit të studentëve është bazuar Ligjin</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë</td></tr>
</table>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore.<br>Informacioni në lidhje më kurrikulat dhe programet që institucioni ofron vihet në dispocion të publikut dhe shpërndahet përmes rrugëve te ndryshme të komunikimit.<br><br>Gjithashtu në kuadër të fillimit të vitit të ri akademik, UET zhvillon Javën e Orientimit më qëllim njohjen e studentëve të rinj me programet, pedagogët, ambjentet dhe rregullat bazë të universitetit. **(Dok. Komunikimi i integruar i marketingut, Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online)** |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. | |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e pranimit. Ato janë publike dhe të aksesueshme nga të gjithë. Programi i studimit zgjat një vit akademik e për rrjedhojë nuk ka kritere të kalimit nga njëri vit në tjetrin.<br>Në rregulloren e UET Kreu VII, tregohen kriteret dhe proceduat e njohjes se kualifikimeve të mëparshmë dhe modalitetet e transferimit nga shkolla të tjera universitare dhe njëkohësisht modalitetet e transferimit te studenteve te UET drejt shkollave të tjera universitare.<br>Institucioni në fillim të vitit akademik, studentët informohen përmes koordiantores së departamentit për përmbjtjen e syllabusit pjësë e të cilit është edhe mënyra dhe kriteret e vlerësimit të dijëve në programin e studimit. **(Rregullore e programit të studimit_MP Infermieri me profile).**<br><br>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Modalitet përkatëse, si plani i diplomimin që nga që nga momenti i aplikimit, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës të Departamentit, e deri në dorëzimin dhe mbrojtjen janë të dokumentuara. **(Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit)**<br><br>UET në fillimit të vitit të ri akademik, zhvillon Javën e Orientimit më |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e | |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| studimit. | qëllim njohjen e studentëve të rinj me programet, pedagogët, ambjentet dhe rregullat bazë të universitetit. ( **Dok Komunikimi i integruar i marketingut, Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online)** |
| **Kriteri 5**. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Studentët e programit të studimit informohen nga stafi akademik, kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit dhe rregullores mësimore të programit të studimit për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve (**takimi me studentët)** Programi i studimit dhe plani mësimor përmbajnë informacionin me kohëzgjatjen e studimeve dhe ngarkesën në orë dhe kredite **[programi], [plani mësimor]** UET ve në dispozicion të studentëve informacione dhe dokumente për zhvillimin e lëndëvet/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, këto programe u dërgohen elektronikisht nga koordinatorja e departamentit. Silabuset dhe materialet e leximit për secilën lëndë hidhen edhe në sistemin LMS (Learning Managment System). Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të universitetit ëëë.uet.edu.al. **(verifikuar nga GVJ).** Shumica e studenteve të këtij program studimi ishin në marrëdhënie pune në institucione të ndryshme shëndetësore. Mbi mundësitë e punësimit të tyre, institucioni i orienton përmes zyrës së karrierës, bordeve të tregut të punës dhe organizimit të panairit të punës, dërgimit të njoftimeve në lidhje me mundësitë e punësimit. . (Dok Bordi i Tregut të Punës 2018-2019, Dita e Biznesit në UET; http://uet.edu.al/neë/dita-e-biznesit-ne-uet/; http://uet.edu.al/neë/edukimi-financiar-sa-te-informuar-jane-te-rinjte-sot/ ***GVJ rekomandon që institucioni të asistojë studentët në të gjitha veprimtaritë jashtë kurrikulare dhe të punësimit me qëllim jo vetëm integrimin e tyre të e shpejtë të tyre në tregun e punës por*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

<table>
<tr><td>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</td><td colspan="4">dhë zhvillimin e tyre të mëtejshëm akademik dhe profesional.<br><br>Në takimin me studentët, mori pjesë vetëm një studënt i cili ishte në marrëdhënie punë, duke mos e pasur kështu të nevojshme ndihmën e zyrës.<br>Instucioni përmes koordinatores së departamentit mban kontakte të rregullta me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit duke i përditësuar mbi zhvillim , organizimin e procesit mesimor dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informacionet përcillen përmes telefonatave, email dhe sistemit LMS.<br><br>Sistemin e menaxhimit të brendshëm LMS i cili disponohet nga institucioni lehtëson komunikimin me studentet në lidhjë me programin e studimit edhe kur ata janë në distancë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi V.4<br>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</td><td rowspan="2">Institucioni disponon të dhëna në lidhje me numrin e studenteve të rregistruar dhe diplomuar në programin e studimit, duke qenë se në programin MP Infermieri me profile, me profile akoma nuk është diplomuar brezi i parë, të dhënat janë për cilësinë në hyrje të studentëve dhe informacion mbi punësimin aktualtë tyre [vizita në IAL]<br><br>Institucioni disponon të dhëna në lidhje me studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar, si edhe studentët e diplomuar për secilin program studimi.<br><br>Nga verifikimi i dokumentacionit në letër (hard -copy), GVJ nuk identifikoi ndonjë pasakatësi që lidhen me mungesa në dokumentacion, mungesë të numrit të matrikullimit apo pasaktësi në plotësimin e regjistrit themeltar.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</td><td rowspan="2">Institucioni arkivon rezultatet e të nxënësit. Procesverbalet e provimeve ruhen në sekretarinë mësimore.<br><br>Provimet dhe testimet, instucioni deklaron se realizohen me komisione por GVJ identifikoi raste ku procesverbalet ishin të firmosura vetëm nga një anëtar.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Të dhënat statistikore</td></tr>
</table>



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Në programin MP Infermieri me profile janë të rregjistruar për vitin akademik **2018-2019**: **5** studente në profilin Infermieri e Kujdesit Parësor, Infermieri Kirurgjikale, asnje student në Dietologji dhe Nutricion. Për vitin akademik **2019-2020** 5 studente profili Infermieri e Kujdesit Parësor | | | |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | 6 studente Infermieri Kirurgjikale, asnje student ne Dietologji dhe Nutricion.<br>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. Verifikuar gjatë vizitës në IAL. Institucioni disponon Sistemimin e menaxhimit të Informacionit UMIS I cili mundëson ruajten, menaxhimin dhe aksesin e të dhënave për personat e autorizuar.<br>Institucioni deklaron se meqënëse, Programi MP Infermieri me profile ka vetëm një vit që është hapur, akoma nuk është hartuar një raport analitik mbi cilësinë në dalje dhe shkallën e punësimit, praktikë kjo e ndjekur dhe për programe të tjera. ***GVJ rekomandon përpilimin e raportit analitik për këta studente me qëllim evidentimin e problemeve ne cilesinë e daljes, punësimin dhe marrjen e masave të duhura për përmirësimin e treguesve.*** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Bazuar në dokumentet kryesore të institucionit (statuti, rregullorja e përgjithshme etj), studentët janë të përfshirë në strukturat vendimmarrëse të UET. Strukturat kryesore:<br>• Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.<br>• Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve.<br>• Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve.<br>• KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.<br>• Mbledhjet e departamenteve, një në muaj është e hapur për studentët. |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik është e mundur bazuar në aktet rregullatore, por GVJ nuk ka mundur të verifikojë përfshirjen e studenteve të |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | programit të studimit MP në Infermieri me profile në vendimmarrje dhe impaktin e këtij përfaqësimi. ***Në takimin me studentet ishte i pranishëm vetëm një student, gjithashtu studentja pjesë e grupit të hartimit të raaportit të vlerësimit të brendshëm nuk ishte e pranishme. Në këto kushte ky tregues kriteri është i vështirë për tu matur dhe vlerësuar.***<br><br>*Në RVB Kriteri 3 i këtij standarti është komentuar gabim dhe nuk shjegon kërkesën përkatëse rrjedhimisht GVJ nuk mund të japë vlerësim për këtë kriter* |
| **Kriteri 4**. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Programi i studimit MP në Infermieri me profile ka një vit që ka filluar dhe nuk i është nënshtruar ndyshimeve dhe përmirësimëve. Instucionini deklaron që përfshirja e studenteve procesin e rishikimt përmirësimit të progrogramit realizohet me anë të pyetsoreve të studentëve. GVJ nuk ju vunë në dispozicion pyetsorët përkates të studentëve të cilët ndjekin këtë program studimi.<br>***GVJ propozon që gjatë fazës së rishikimit të kurrikulës, të përfshihen studentë dhe ku është e mundur të reflektohen sugjerimet dhe propozimet e tyre.*** |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve realizohet sipas një procesi transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të institucionit. Provimet realizohen të sekretuara dhe pedagogu organizon seanca sqaruese me qëllim argumentimin e vlerësimit. Studentet kanë mundësinë e rivlerësimit nga një komision i posatshëm pas plotësimit të një kërkëse më shkrim. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Institucioni ka njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, zyra e Kujdesit ndaj Studentit **(Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit)** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, | Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencën përkatëse për çështje akademike dhe studentore **(Dok. Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik).** |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. . | Informimi, këshillimi, ndjekja e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit realizohet nga Zyra e kujdesit nga Studenti, Zyra e Karrierës dhe Sekretaria Mësimore. Informacioni dhe orientimi e studentëve në lidhje me procesin mësimor, orientimin për praktikën profesionale realizohet kryesisht në nivel departamente nga kordinatorja e programit.<br>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyra e Keshillimit te Karrieres, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, në këtë program studimi ende ***nuk janë diplomar studentet e parë dhe GVJ nuk mund të vlerësojë aktivitetin e ketyre njësive***.<br><br>**Gjatë takimit më studentin u deklarua personeli akademik luan një rol të rëndësishëm si në këshillim akademik ashtu edhe këshillim karriere.**<br><br>Kriteri 4 i paaplikueshëm pasi ende nuk ka student të diplomuar. Komenti ne RVJ nuk i takon studenteve te ketij programi. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## VI SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

| |
|---|
| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | UET ka politika,stuktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjëgjësistë institucionale për sugurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve te mmësimdhënies. Këto politika përcaktohen ne nenin 11 të ketij statuti dhe janë në përputhje më parashikimet ligjore e nënligjore. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Institucioni ka ngritur dhe ka funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. IAL, bazuar në Nenin 16 të Statutit ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i cili funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. Zyra ka rregulloren mbi të cilën bazon aktivitetin e saj.<br>Në detyrat e KSBC përfshihet vlerësimi i rezultateve të veprimtarive mesimore, kërkimore shkencore dhe propozon ndryshime të nevojshme në funksion përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. (Neni16, Statuti i UET ,takim me përfaqsues të zyrës. ) |
| **Kriteri 3.** Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Institucioni ka dhe përdor instrumenta për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. UET i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | Njësia e sigurimit të brendshëm deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të Universitetit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm të cilat diskutohen në të gjitha njësitë e UET (Neni16, Statuti i UET ,takim me përfaqsues të zyrës. ). ***GVJ nuk gjeti Raporte Vjetore te Institucionit apo analiza dhe vleresime konkrete të realizuar nga KSBC.***<br><br>KSBS funksion në bazë të programi të hollësishëm punë i cili përfshin gjithë institucion por nuk ka aktivitet konkret me anë të grupëve ad-hoc në nivel njësie kryesore apo njësie baze. Analiza vjetore e programit ka të dhëna sasiore por nuk bën analizë apo adresim të problematikave. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Standardi VI.2 |
|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë** |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

<table>
<tr><td colspan="5">periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td colspan="4">Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</td><td colspan="4">Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikqyrjen dhe rishikimin e programeve te ciklit të dytë të studimeve. Njësia përgjegjëse për kryerjen e këtij funksioni është Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave (Statuti UET, Neni 30)</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</td><td colspan="4">Institucion ka ralizuar një analizë vjetore të ketij programi studimi ku janë përfshirë informacione në lidhje me kurrikulën dhe personelin e angazhuar në program, përditësimi e literaturës, rezultatet e studenteve( vëtëm kalueshmëria). Por më tej GVJ nuk ka evidentuar procese konkrete të dokumentuara të mbikqyrjes, rishqyrtimit rishikimit më qëllim përmirësimin në këtë program studimi. RVJ në koment të këtij kriteri vetëm i referohet nenit 11 të statutit si bazë ligjore duke konfonduar ciklin e parë më atë të dytë të studimeve në shpjegimin e kriterit 1 dhe 2 st VI.2.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</td><td colspan="4" rowspan="3">Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ nuk identifikoi procese dhe rezultate të anketimit të studentëve dhe as mekanizma apo metoda të tërthorta vlerësimi dhe verifikimi në funksion të trhëqjës së informacionit.<br><br>GVJ identifikoi se KSBC por edhe strukturat e tjera të KUR kanë eficencë të ulët në regjistrimin e informacioneve, analizës dhe raportimit ndaj titullarëve apo publikut në kuadër të informimit në këtë program studimi .Gjithashtu mungojnë rekomandime dhe plan pune që adreson përmirësimin e problematikave të evidentuara.<br><br>Në këtë kuadër GVJ, rekomandon të përmirësimit të proceseve punës të cilat lidhen me dokumentimin, analizën e informacionit apo të dhënave, raportimin dhe propozimet / rekomandimet për adresimin në të ardhmen të problematikave që kanë nevojë të përmirësohen.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

| **Standardi VI.3** |
|---|


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| **Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Bazuar në dokumentet e UET dhe nga informacioni i marrë, rezulton se vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike.<br><br>Metodat dhe instrumente të ndryshme për monitorimin i mësimdhënies, *vlerësim të cilësisë së mësimdhënies ,vlerësim të anës pedagogjike të mësimdhënies* vleresimin e pedagogeve nga studentët dhe nga eprorët, monitorimi i provimeve, dëgjimë në auditor, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve , praktikës etj, u deklarua se zhvillohen në mënyrë periodike **[takimi me drejtuesit]**.<br><br>Gjithashtu edhe në planin vjetor të punës janë parashikuar aktivitete në lidhje me vlerësimin e kurrikulave, vleresimin e mesimdhenies, vlerëimi e punës kerkimore shkencore etj. **[plani i punës KSBC].**<br><br>***GVJ nuk evidentoi vlerësim të programit të studimit përmes*** testimeve lokale apo të standardizuara, testime ndër institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara pasi programi është në vitin e parë të realizimit.<br><br>***Instrumenta të tërthorta të vlerësimit si sondazhe të studentëve , të pe rsonelit akademik, ndihmës akademik apo të institucioneve të cilat bashkëpunojnë për programin e studimit deklarohet që zhvillohen sipas RVB i cili i referohet nenit 11 të statutit , por GVJ nuk ka evidenca konkrete të këtyre vlerësimeve.***<br><br>Theksojmë që aktorët e jashtëm japin një kontribut mjaft pozitiv në realizimin e praktikave mësimore e profesionale por *mungon kontributi i tyre konkret në vlerësimin e realizimit dhe cilësisë së programit të studimit në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij*.<br><br>Programi ende nuk e ka formuar rrjetin e tij Alumni, pasi nuk janë diplomuar ende studentet e parë. |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor | |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi | Institucioni, nëpërmjet akteve të tij si statut, rregullore, garanton përfshirjen e studentëve dhe personelit akademik si aktor të brendshëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë,përfshirjen e për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Komisioni përbëhët përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe një përfaqësues ekspert i jashtëm.<br>Anëtarët përbërës të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, kanë përgjegjësi dhe detyra konkrete dhe të ndryshme, më qëllim garantimin e cilësisë së programit.<br><br>Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit është garantuar nga statuti i institucionit dhe rregullorja e KUR.<br><br>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit përpiqët të shmange çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përcaktuara sipas Nenit 42 mbi Të drejtat e Studentëve ( rregullore e UET) duke |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| të këtyre detyrave. | respektuar integritetin akademik dhe shmangjen e diskriminimit apo pabarazisë.<br>KUR ka eksperiencë pozitive në angazhimin e personave të kualifikuar dhe profesionistëve si pjesë e personelit akademik me kontratë. Në këtë drejtim kontributi i tyre është i dukshëm në ofrimin e programit. ***Mendojmë që angazhimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj duhët të rritet dhe të të këtë efekte konkrete në përmirësimin e tij.*** |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. | |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.5**<br><br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, | Në faqen zyrtare të institucionit janë publikuar mjaft informacione që |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

<table>
<tr><td>organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</td><td colspan="4" rowspan="5">informojnë publikun dhe studentët e rinj. Dokumentet kryesore janë publike dhe të aksesueshme në faqen e internetit. Ndërkohë mungojnë informacionët në lidhje më veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si për institucionin në tërësi dhe për programin e studimit në veçanti[faqja e internetit UET].<br><br>GVJ konstaton që informacionet në lidhje më rezultatin e vlerësimit të programit të studimit mungojnë.<br><br>GVJ nuk evidentoi raste të thyerjes së lirisë akademike apo shkelje të legjislacionit për të dhënat personale.<br><br>GVJ theksoi më lart se në raportimet që janë kryer nga IAL janë raporte përshkruese jo analitike. Këto raportë nuk shoqërohen me plane masash apo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Prandaj GVJ ritthekson që në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, institucioni duhet të zhvillojnë më tej mekanizmat analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm<br><br>KSBC ka një plan punë të detajuar të aktivitëti të saj, por GVJ nuk evidentoi aktivitete me personelin dhe studentët më qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Infermeri." me profile Infermieri Kirurgjikale, Infermieri në Kujdesin Shëndetësor Parësor, Nutricion dhe Dietologji, të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i Tiranës"

**Pika të forta dhe afirmime:**

1. Mësimdhënia është e bazuar në metoda bashkëkohore dhe sistem e-learning në shërbim të studentëve dhe personelit akademik.
2. Cilësia e personelit akademik të rekrutuar në mësimdhënie, i cili ka grada e tituj shkencorë, eksperiencë në mësimëdhënie dhe përvojë profesionale në fushën e shkencave mjekësore
3. Bashkëpunimi me përfaqësues të tregut të punës dhe përfshirja e tyre në procesin e rishikimit të programeve të studimit, apo në mësimdhënie për tema specifike të ekspertizës së tyre profesionale, e cila ndihmon që programi t'i përgjigjet më mirë kërkesave të tregut të punës dhe punësimin e studentëve pas diplomimit.

**Pika të dobëta:**

1. Mungesa e laboratorëve mjekësor për zhvillimin e praktikave mësimore të cilat duhet të jenë brënda institucionit dhe nuk mund të realizohen me kontrata me laboratore jashtë institucionit arsimore.
2. Në kurikulen e programit, në të tre profilet vihet re nje shpërndarje e papërshtashme të ETC-vë midis lëndëve integruese dhe karakterizuese (***që nuk lidhen direkt me profilin***).
3. Në kurikulën e programit janë prezente lëndë të cilat nuk lidhen direkt më profilin e programit dhe mungojnë lëndë të domosdoshme për formimin profesional në profilin që ofron program i studimit.
4. Mospërputhje e ngarkesës mësimorë në orë dhe ECTS të paraqitur në programin mësimor me atë të stafit akademik të përfshirë në program.
5. Stafi akademik efektiv realizon reth 60% të ngarkesës mësimore në program duke mos përmbushur detyrimet ligjore. Sic është përmendur dhe në raport GVJ nuk mund të llogarisë me saktësi ngarkesën në orë dhe ETC që mbulohet nga PAE dhe PAK sepse në ngarkesën mësimorë nuk është e përfshirë praktika profesionale, ka mospërputhjes së ngarkesës mësimore të petagogëve me atë të planit mësimor, apo ka lëndë që zhvillohen nga pedagogë


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

PAE dhe PAK në të cilat ngarkesa mësimore nuk është përcaktuar për secilin pedagog por në total për lëndën.

6. Sylabuset nuk janë hartuar në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*", por në to mungon titullari i lëndës i cili duhet të jetë i kategorisë profesor, mungojnë syllabuset për praktikën profesionle, lëndët dietologji e aplikuar, këshillim edukim dhe terapi e të ushqyerit, diagnostikë nutricionale.
7. Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe lidhur me këtë program studimi në formën hard copy. Dhe mungesa e titujve mjekësore në gjuhën shqipe në bilotekën e institucionit.
8. Mosqëndrueshmëria e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi.
9. Përpilimi dhe paraqitja e papërshtashme e dokumnetacionit, mungesa e analizës së informacionit dhe raportimi.
10. Mungesae analizës vjetore të realizuar nga KSBC lidhur me prorogramin estudimit.
11. Punësimi i stafit akademi me kohe të plotë në dy institucione njëkohësisht me kohë të plotë
12. Mungesa e marrëveshjeve me institucionet shendetësore ku studentët kanë kryer praktikën profesionale.

**Rekomandime**

1. Rregulloret të hartohen sipas formatit zyrtar dhe të përshtaten për kët ë program studimi.
2. Rishikim e kurikulës dhe rishpërndarje të ECTS-ve në lëndët karakterizuese që nuk lidhen direkt me profilin. Psh në MP në infermieri reduktimi i ECTS në mjekësi laboratorike dhe futja e lëndëve që lidhen me këtë profil si njohuri mbi infeksionet nozokomiale për profilin infermieri kirurgjikale.
3. Rishikimin e ngarkesës mësimore të pasquar në programin mësimor dhe shpërndarjes së saj në pedagogët e përfshirë në këtë program studimi.
4. Referuar legjislacionit në fuqi 70% e ngarkesës mësimore të realizohet nga stafi akakdemik efektiv.
5. Formalizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me instutcionet për realizimine praktikës profesionale.
6. Rishikimi i formatin të sylabuseve dhe hartimin e sylabuse që mungojnë.
7. Hartimi i një procedure të qartë dhe të rinovuar e cila të bazohet edhe në përcaktimet e IAL edhe në Udhëzimit 29, i ndryshuar për ngarkesën mësimore për personelin akademik.
8. Të plotësohet dhe përditësohet dokumentacioni i personelit veçanërisht CV dhe aktivitetit të tyre kërkimor e shkencor.



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

9. Sigurimin e literaturës/leksioneve të shkruar/printuara për programin e studimit për të kompesuar mungesën e literaturës në gjuhën shqipe
10. Institucioni të angazhohet në krijimin e mundësive për kualifikimin e vazhdueshëm dhe krijimin e mundësivë për zhvillimin shkencor të personelit akademik i cili mbulon shkencat mjekësore në përgjithësi dhe programin MPMI në vecanti
11. Institucioni të asistojë studentët në të gjitha veprimtaritë jashtë kurrikulare dhe të punësimit me qëllim jo vetëm integrimin e tyre të e shpejtë të tyre në tregun e punës por dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm akademik dhe profesional.
12. Përpilimi i raportit analitik për studentet me qëllim evidentimin e problemeve ne cilesinë e daljes, punësimin dhe marrjen e masave të duhura për përmirësimin e treguesve.
13. Gjatë fazës së rishikimit të kurrikulës, të përfshihen studentë dhe ku është e mundur të reflektohen sugjerimet dhe propozimet e tyre.
14. Përmirësimin e proceseve të punës të cilat lidhen me dokumentimin, analizën e informacionit apo të dhënave, raportimin dhe propozimet / rekomandimet për adresimin në të ardhmen të problematikave që kanë nevojë të përmirësohen.
15. Hartimi i raporteve financiare nga institucioni për këtë program studimi si dhe procedurës për hartimin e buxhetit, alokimin dhe realizimin e tij në nivel institucional dhe të programit të studimit.

**SUMMARY ANALYSIS OF IMPLEMENTATION OF THE STUDY PROGRAM The RVJ closes with the "Comprehensive Analysis of the RVJ" under the SWOT method (Strength-Strong Points, Weaknesses - Weak Points, Opportunities, Threats).**

**Strength and affirmations:**

1. Teaching process is based on contemporary methods and e-learning system at the service of students and academic staff.
2. Quality of academic staff recruited in teaching, who has scientific degrees and academic titles, teaching experience and professional experience in the field of medical sciences
3. Cooperation with labor market representatives and involve them in the process of reviewing study programs, or in teaching specific topics of their professional expertise, which helps the program respond better to labor market demands and student employment after graduation.

**Weakness:**

1. Lack of medical laboratories, indispensable for the development of teaching practices. These laboratories should be within the institution of higher education (IHE) because the teaching practice cannot be realized through laboratories contracts outside the educational institution.
2. In the curriculum of the program, all three profiles show inappropriate distribution of ETCs between integrating and characterizing subjects (not directly related to the profile).
3. The curriculum of the program contains subjects that are not directly related to the profile of the program and lack the necessary subject for professional training in the profile offered by the study program.
4. Discrepancy between teaching load per hour and ETC presented in the curriculum with that of the academic staff involved in the program.
5. Effective academic staff accomplish approximately 60% of the teaching load in the program by failing to meet legal obligations. As mentioned in the report, the expert cannot calculate accurately the teaching load in hours and ETC covered by the effective academic staff(EAS) and contrat academic staff (CAS) because of some reason as the professional practice is not involved in the teaching load, there is a discrepancy between the teaching load of the teachers(reflected in respective document) and the syllabus, or some subject/syllabus realized by two lecturer together ( EAS and CAS) in which the teaching load is not determined for each lecturer but in total for the subject.
6. Syllabuses are not designed in accordance with DCM 41 dated 24.1.2018 "On the elements of study programs offered by higher education institutions", in them lack the title of the subject which should be of the professor category, lack the syllabuses for professional practice, applied dietology subjects, education, counseling and nutrition therapy, nutritional diagnostics.
7. Lack of literature in Albanian language related to this study program in hard copy. And the lack of medical titles in Albanian language in the institution's library.
8. Instability of the academic staff involved in this study program.
9. Inappropriate compilation and presentation of documentation, lack of information analysis and reporting.
10. Lack of annual analysis carried out by KSBC regarding the prorgram of the study.
11. Employment full-time academic staff in two institutions at the same time full-time
12. Lack of agreements with health institutions where students have carry out professional practice.

**Recommendations:**

1. The regulations should be drafted in the official format and adapted for this study program.
2. Revision of the curriculum and reallocation of ETC in characteristic subjects not directly related to the profile. For example in PM in nursing reduction of ECTS in laboratory medicine and the introduction of subjects related to this profile as knowledge of nosocomial infections for the surgical nursing profile.
3. Review of the teaching load reflected in the syllabus and its distribution to the teachers involved in this study program.
4. Refer to the legislation in force, 70% of the teaching load to be carried out by effective academic staff.
5. Formalize cooperation agreements with institutions for the realization of professional practice.
6. Revision of syllabus format and design of missing syllabuses.
7. Develop a clear and updated procedure based on both HEI criteria and 29 Guideline amended, for teaching load of academic staff.
8. To Complete and update staff documentation, especially CVs and their scientific research activity.
9. Providing written / printed literature / lectures for the study program to compensate the lack of literature in the Albanian language
10. The institution must be engaged in providing opportunities for continuing training and scientific development of academic staff, who covering medical sciences, particulary the PMI program.
11. Institution to assist students in all extracurricular and employment activities aiming not only their rapid integration into the labor market but also further their academic and professional development .
12. Compilation of analytical report for students in order to identify problems in the their quality of exit, employment of students and take appropriate measures to improve indicators.
13. The students must be involve in curriculum review phase, and where possible must be reflect their suggestions and proposals.
14. Improving work processes related to documentation, analysis of information or data, reporting and suggestions / recommendations for future addressing of issues that need to be improved.
15. Preparation of financial reports for this study program as well as the procedure for budgeting, allocation and its implementation at institutional and study program level.



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

**SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | X | | |
| MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | X | |
| BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | X | | |
| STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | X | |
| SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | X | |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | X | | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al